

RAPORTI I NJSBC
VITI AKADEMIK 2019-2020
KOLEGJI UNIVERSITAR “BEDËR”

PASQYRA E LËNDËS

1. REALIZIMI I MISIONIT, QËLLIMEVE, OBJEKTIVAVE TË MËSIMDHËNIES DHE KËRKIMIT SHKENCOR	3
1.2 INFORMACION MBI KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCION APO MBI PROJEKTET QË MERR PJESË SI PALË AKTIVE.....	7
2. TË DHËNA MBI PROGRAMET E STUDIMIT	19
2.1 Programet e studimit të ofruara dhe programet e studimit në proces licencimi	19
2.2 Përshtatshmëria e programeve të studimit me misionin e institucionit dhe lidhja me tregun e punës	20
3. NDRYSHIMET NË STATUTIN DHE RREGULLORET E IAL-SË DHE NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË	46
4. GJURMIMI I STUDENTËVE TË DIPLOMUAR - “BEDER” ALUMNI	75
4.1 Institucionet.....	75
5. KËSHILLI STUDENTOR, STUDENTËT DHE PËRFAQËSIMI NË ORGANET DREJTUESE TË IAL-SË	79
6. TË DHËNA MBI STUDENTËT	88
6.1 Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar	88
6.2 Numri i studentëve që ndjekin programet që përbëjnë përparësi kombëtare.....	90
6.3 Numri i studentëve të shkëlqyer.	90
6.4 Numri i studentëve të çregjistruar ose të transferuar.	91
6.5 Numri i studentëve që kanë fituar bursa ose zbritje nga tarifa e studimit.....	93
6.6 Lëvizshmëria (mobiliteti) i studentëve dhe përfshirja në projekte ndërkombëtare ..	94
6.7 Numri i studentëve kalues në vit dhe atyre të diplomuar.....	97
7. FINANCIMI DHE MENAXHIMI I BURIMEVE	100
7.1 Plani buxhetor afatmesëm dhe plani strategjik i zhvillimit të institucionit	100
7.2 Shlyerja e detyrimeve tatimore si dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore.....	106
8. PLOTËSIMI I STANDARDEVE SHTETËRORE AKADEMIKE DHE INFRASTRUKTURORE	108
9. ANKETAT	125
9.1 Anketa në lidhje me mësimdhënien në distancë	125

1. REALIZIMI I MISIONIT, QËLLIMEVE, OBJEKTIVAVE TË MËSIMDHËNIES DHE KËRKIMIT SHKENCOR

Misioni i Kolegjit Universitar “Bedër”, i cili nisi veprimtarinë në vitin akademik 2011-2012, është përgatitja e individëve të kualifikuar, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale dhe mbështetjen e kërkimit shkencor, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve në shërbim të shoqërisë.

Misioni i sipërpërmendur është konceptuar në harmoni të plotë me misionin e përgjithshëm të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë (shprehur në nenin 1 të ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”) me standardet ndërkombëtare, Kartën e Bolonjës, si dhe me veçantitë e risitë që synon të sjellë ky institucion në vendin tonë dhe më gjerë.

Në kuadër të përmbushjes së misionit dhe rolit që institucionet e arsimit të lartë, në tërësinë e tyre, kanë në dobi të shoqërisë ku zhvillojnë aktivitetin, Kolegji Universitar “Bedër”, gjatë vitit akademik 2019-2020, realizoi aktivitete të shumëllojshme në fushën e mësimdhënies, të kërkimit shkencor, konferencave ndërkombëtare në disa fusha, organizim të aktiviteteve të ndryshme sociale, kulturore dhe sportive, me pjesëmarrjen aktive të studentëve në nisma të ndërmarra nga vet ata, në bashkëpunim me institucione të ndryshme në dobi të shoqërisë. Në këtë vit akademik, për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, pjesa më e madhe e aktiviteteve janë zhvilluar virtualisht.

Kolegji Universitar “Bedër”, e zhvilloi aktivitetin e tij të mësimdhënies cilësore në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në dy fakultete: Fakulteti i Shkencave Humane dhe Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit, përkatësisht në këto departamente: drejtësi, shkenca islame, shkenca komunikimi, gjuhë dhe letërsi angleze, shkenca kompjuterike dhe shkenca edukimi.

Kërkues shkencorë dhe studiues nga vendi, rajoni dhe mbarë bota kanë marrë pjesë në konferencat shkencore ndërkombëtare, të organizuara nga Kolegji Universitar “Bedër”. Ata prezantuan punimet dhe kërkimet e tyre rreth temave bashkëkohore që janë problematike për rajonin dhe Shqipërinë, duke përbërë një bazë të mirë rekomandimesh për grupet e interesit.

REALIZIMI VJETOR I OBJEKTIVAVE TË INSTITUCIONIT

Realizimi i objektivave të mësimdhënies

Me anë të përdorimit të metodologjive të ndryshme të mësimdhënies dhe të vlerësimit, me anë të integritit të teknologjisë në mësimdhënie, prej zotërimit dhe vënies në dispozicion të mjediseve bashkëkohore të pajisura me infrastrukturë bashkëkohore, programet e ofruara nga Kolegji Universitar “Bedër” synojnë dhe vlerësohet të kenë arritur nivelin e një arsimi cilësor që promovon mendimin analitik dhe gjykimin kritik në përgatitjen e studentëve për identifikimin, analizën, ndërtimin dhe vlerësimin e argumenteve.

Mësimdhënia cilësore dhe vlerësimi etik dhe profesional në KUB ka siguruar për të gjithë studentët mundësi të shkëlqyera për të përmbushur potencialin e tyre të plotë akademik, duke u mundësuar atyre të formohen në një mjedis arsimimi që u jep zemër dhe i mbështet, por dhe ku progresi akademik dhe rezultatet monitorohen e vlerësohen në mënyra alternative.

Përmes realizimit të një mësimdhënieje cilësore, bashkëkohore në përputhje me kurrikulat evropiane të arsimit të lartë është bërë i mundur sigurimi i një cilësie, që i pajis studentët me njohuri teorike dhe aftësi praktike, duke u dhënë siguri për një përshtatje më të mirë me mjedisin e ardhshëm të punës. Kjo është arritur nëpërmjet realizimit të leksioneve të përbashkëta për studentët e interesuar nga të gjitha departamentet dhe disiplinat, ndërtimit të një bashkëpunimi efektiv ndërmjet njësive kryesore, me mbështetjen e dekanatit të studentëve, zyrës së planifikimit të karrierës, këshilltarëve akademikë dhe zyra të tjera në ndihmë të studentëve etj.

Përmes zgjerimit të mundësive për aktivitete të larmishme, si dhe me mundësitë për praktika ndërkombëtare, konkurset studentore dhe praktikat mësimore, përmes nxitjes së bashkëpunimit me universitete jashtë vendit dhe rritjes së kuotave të shkëmbimit të studentëve është arritur rritja e mundësive dhe përvojave ndërkombëtare.

Përmes organizimit të platformave të ndryshme të mësimdhënies online, u arrit përfundimi me sukses i procesit të vitit akademik 2019-2020.

Realizimi i objektivave të kërkimit shkencor dhe inovacionit

KUB ka synuar dhe synon përherë të sigurojë një komunitet kërkimor të suksesshëm dhe interaktiv që gjeneron ide, krijon fusha të reja të dijes dhe ndikon në ndryshimin e zhvillimit shoqëror, kulturor, mjedisor të Shqipërisë dhe komuniteteve globale. Hulumtimi përfshin personelin akademik, si dhe studentë të programeve të studimit në ciklin e parë “Bachelor” dhe ciklin e dytë “Master”.

Është arritur nxitja dhe mbështetja e pjesëmarrjes aktive të personelit akademik dhe studentëve në projekte dhe veprimtari kërkimore-shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo veprimtari është mundësuar nëpërmjet organizimit të ëorkshop-eve, konferencave shkencore, seminareve, simpoziumeve dhe trajnimeve të organizuara në bashkëpunim me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Janë ngritur dhe janë në funksionim mekanizma të vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm për vlerësimin e performancës së aktiviteteve ndërdisiplinare (programet pasuniversitare, aktivitete kërkimore, etj.);

Është rritur niveli aktual i angazhimit dhe produktiviteti i personelit akademik, studentëve të diplomuar dhe atyre aktualë.

Janë marrë masa dhe zhvilluar aktivitete me bazë departamenti, fakulteti dhe institucioni për mbështetjen e inovacionit dhe ideve që ndikojnë në nxitjen e zhvillimit të shoqërisë dhe rritjen e ndikimit ndërkombëtar të institucionit.

Kjo dëshmohet në përfshirjen e personelit akademik dhe studentëve në shprehjen e ideve dhe mbështetjen e inovacionit si dhe në nxitjen dhe motivimin e tyre, që të fitojnë dhe të përdorin aftësitë e tyre sipërmarrëse dhe menaxhuese.

Është mbështetur shkëmbimi inovativ i përvojave të personelit akademik dhe studentëve me reparte dhe sektorë industrialë, institucione të ndryshme prodhuese apo me ofruesit e shërbimeve publike, por ndërkohë janë nxitur lidhjet me biznesin dhe komunitetin financiar për të mbështetur inovacionin dhe aktivitetet e institucionit.

Brenda mundësive që ofron Ligji i Arsimit të Lartë institucioni ynë arsimor ka prodhuar një sërë politikash që kanë ndihmuar në ecurinë sasiore dhe veçmas asaj cilësore. Në Statutin e KU “Bedër”, Neni 4, Misioni dhe qëllimi i Kolegjit Universitar “Bedër”, është përcaktuar shprehimisht:

“Njohja me Deklaratën e Bolonjës (1999) dhe zbatimin e Procesit të Bolonjës (2003) u hapi udhë përprjekjeve tona për t’u bërë pjesë e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë si dhe të kërkimit shkencor. Kontaktet institucionale të ndërthurura me ato personale të anëtarëve të personelit akademik me institucione dhe personel të IAL-ve të BE-së dhe SHBA-ve sollën njohjen më imtësisht, e cila ka ndihmuar për evidentimin më të mirë të përfitimeve prej zbatimit të parimeve që burojnë nga Deklarata e Bolonjës.”

Njëherazi me Konferencat Ndërkombëtare Shkencore në nivel departamenti dhe fakulteti, ku bashkë me pedagogët kanë mundur të jenë pjesëmarrës edhe studentë të ciklit të dytë të studimeve, kanë shkuar krahas Konferencat Ndërkombëtare Shkencore të zhvilluara nga studentët, gjithnjë me ndihmën e njësive bazë, por dhe të Drejtorisë së Marrëdhënieve me Studentët, me zyrat e veta, së bashkë me Këshillin e Studentor

Si pasojë e projekteve të fituara dhe të realizuara me cilësi, disa pedagogë dhe mjaft studentë kanë realizuar projekte studimore apo vijuar studimet dhe kryer veprimtaritë shkencore në institucione të shquara brenda dhe jashtë shtetit.

Produktet e kërkimit shkencor janë të botuara në Proceeding me PDF, janë dokumentuar fizikisht në përmbledhje, ndërkohë që pritjet të dalë nr. 12 i revistës “BJH” të Fakultetit të Shkencave Humane, që veç ISSN-së që botohet fizikisht, ka fituar edhe ISSN online, duke dhënë mundësi të lexohet në mënyrë digjitale gjithkund dhe kurdoherë. Ndërkohë vijon përgatitja për zhvillimin e 7-th ICHL, që do të mbahet më pas.

Zhvillimi i KU “Bedër” është mbështetur te:

a. Zhvillimi i burimeve njerëzore duke u orientuar drejt kërkimit shkencor dhe inovacionit teknologjik, me synimin për arritje cilësore në profesion.

b. Lëvizshmëria e ekipeve: personeli akademik, ai administrativ i IAL-së së bashku me studentët.

Për realizimin e qëllimeve dhe objektivave janë ngritur dhe funksionojnë mekanizma të vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm për sigurimin e standardeve të aktiviteteve ndërdisiplinare (programet pasuniversitare, aktivitete shkencore-kërkimore, etj.)

Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit (KPGSCIPS)

KPGSCIPS ka në varësi Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë (KPSC). Në KPGSCIPS është bërë miratimi përfundimtar i planit të veprimit për vlerësimin e kërkimit shkencor dhe të planit të veprimit për integrimin e personelit dhe të studentëve të huaj.

Gjithashtu, po në këtë komision, është miratuar plan-veprimi për vlerësimin institucional të kërkimit shkencor, që ka përcaktuar objektivat, veprimtaritë, organin përgjegjës dhe afatin kohor të realizimit për vitin akademik gjegjës.

Për pasojë, është rritur niveli aktual i angazhimit dhe produktiviteti shkencor i personelit akademik, studentëve të diplomuar dhe atyre që vijojnë studimet. Duhet theksuar se janë marrë masa dhe zhvilluar aktivitete me bazë departamenti, fakulteti dhe si institucion për mbështetjen e inovacionit, ideve që ndikojnë në nxitjen e zhvillimit të shoqërisë dhe rritjen e ndikimit rajonal dhe ndërkombëtar të institucionit tonë.

KU “Bedër” ka mbështetur financiarisht jo vetëm procesin mësimor, por dhe prodhimtarinë shkencore, inovacionin e personelit akademik dhe të studentëve. Mbështetja financiare nga shteti shqiptar, që ndonëse modeste shpresojmë se do të vijojë të rritet, edhe për IAL-të joshtetërore, zhvillon më tej garën e tyre me IAL-të shtetërore duke sjellë cilësi – kërkim shkencor efikas – ndërkombëtarizim të tij.

1.2 INFORMACION MBI KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCION APO MBI PROJEKTET QË MERR PJESË SI PALË AKTIVE

1.2.1 POLITIKAT E KËRKIMIT SHKENCOR

Kolegji Universitar “Bedër” (KUB) është një institucion i arsimit të lartë i orientuar drejt kërkimit shkencor dhe si i tillë i kushton vëmendje të veçantë punës kërkimore. Roli i punës kërkimore është të mbështesë mësimdhënien, të pasurojë përvojën si për studentët ashtu dhe personelin akademik dhe të kontribuojnë në ofrimin e studimeve, rekomandimeve dhe alternativave për zgjidhjen e problemeve bashkëkohore.

Bazuar në misionin e tij, Kolegji Universitar “Bedër”, i cili vlerëson dhe mbështet kërkimin shkencor me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe të mbarë shoqërisë, inkurajon të gjithë anëtarët e personelit akademik por dhe studentët për të qenë aktivë në fushën kërkimore, mbështet pjesëmarrjen në aktivitete shkencore dhe angazhimin në projekte kërkimore, si edhe shpërblen efektshmërinë akademike vjetore mbi tregues transparentë të parashikuar në rregulloren përkatëse. Në përfundim të çdo viti akademik, të gjitha publikimet shkencore të botuara nga ana e personelit akademik vlerësohen nga një juri e posaçme, në bazë të kriterëve të përcaktuara në “Rregulloren për nxitjen e publikimeve shkencore” të KUB, duke u pikëzuar sipas kriterëve përkatëse. Gjithashtu, çdo anëtar i personelit akademik përfiton një herë në vit mbështetje financiare për pjesëmarrje në konferenca dhe aktivitete kërkimore-shkencore, të organizuara brenda dhe jashtë vendit.

Ndër politikat e rëndësishme të Kolegji Universitar “Bedër” është nxitja e personelit akademik të institucionit që të publikojnë punët e tyre kërkimore në revista shkencore ndërkombëtare, në përfundim të të cilave ofrohet dhe një ndihmesë financiare. Në bazë të këtyre politikave mbështetëse, numri i artikujve shkencorë të botuar ka arritur në mbi 500 të tillë.

Një tjetër dimension i rëndësishëm i politikës kërkimore-shkencore të Kolegjit Universitar “Bedër” është dhe organizimi ose bashkorganizimi i konferencave dhe aktiviteteve kërkimore-shkencore të një niveli ndërkombëtar. Në kuadër të bashkëpunimit kombëtar, rajonal dhe më gjerë, janë organizuar disa seminare, me pjesëmarrjen e aktorëve të rëndësishëm të fushave gjegjëse.

Pas çdo organizimi shkencor janë përgatitur përmbledhjet e kumtesave të konferencave, të cilat janë pajisur me ISBN nga Biblioteka Kombëtare dhe u janë dërguar pjesëmarrësve, por mund të gjenden online në faqen e internetit të KUB.

Gjithashtu, veç revistës së Fakultetit të Shkencave Humane (FSHH) “BJH”, vijon të publikohet në mënyrë periodike revista shkencore e Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit (FFE) “Beder Journal of Educational Sciences” (BJES), edhe kjo me ISSN të dokumentuar fizikisht dhe online.

Me qëllim mbështetjen e personelit akademik, rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor dhe inovacionit, në përputhje me hartimin e planit të ri strategjik 2018-2023, është rishikuar dhe harmonizuar strategjia e kërkimit shkencor. Gjithashtu janë rishikuar rregullorja dhe procedurat e zyrës së kërkimit shkencor dhe inovacionit në mënyrë që të sigurohet një mbështetje më e plotë dhe efektive e veprimtarisë kërkimore si dhe përputhshmëria me ligjin e ri të arsimit të lartë. Në këtë kuadër, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë të vitit 2015 dhe miratimin e statutit të ri të KUB, institucioni ka ngritur Komisionin e Përherëshëm për Kërkimin Shkencor, Projektet, Aplikimet dhe Inovacionin, i cili ka për detyrë mbikëqyrjen e progresit dhe raporteve përfundimtare të të gjitha granteve dhe projekteve të kërkimit.

Duke parë interesin dhe përfshirjen e vazhdueshme të studentëve në përgatitjen e temave të diplomave, të tezave, në konkurset, projekte të organizuara si pjesë e programeve mësimore, si dhe pjesëmarrjen aktive në konferenca studentore të organizuara nga KUB por edhe jashtë tij, është ngritur "Qendra për kërkuesit e rinj". Qendra ka për qëllim t'u ofrojë studentëve një mundësi unike për të qenë pjesë e veprimtarisë kërkimore të institucionit, si dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në fushën e kërkimit shkencor. E themeluar rishtazi, Qendra e Kërkuesve të Rinj shërben si një mundësi për të gjithë pjesëmarrësit për propozimin e iniciativave kërkimore-shkencore.

Në këtë kuadër, pas trajnimit të studentëve lidhur me metodat kërkimore dhe hartimin e projekteve, qendra ka organizuar konkursin e parë për propozimet në projekte kërkimore-shkencore, kurse projektet fituese do të financohen nga KUB ose do të paraqiten pranë institucioneve donatore.

Një tjetër aspekt i punës kërkimore të kryer në institucion është aplikimi dhe më pas pjesëmarrja, në përgjigje të thirrjeve për projekte nga organizata dhe institucione vendase apo ndërkombëtare, në fushën e kërkimit shkencor.

Në këtë drejtim, me qëllim mbështetjen e punës kërkimore dhe kërkimin aktiv të financimeve të jashtme nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në projekte kërkimore, në institucion vijojnë punën gjashtë grupe kërkimore, përkatësisht: grupi kërkimor për të drejtën ndërkombëtare dhe evropiane, grupi kërkimor për të drejtat e njeriut dhe zgjidhjen e konflikteve, grupi kërkimor për studime mediatike, grupi kërkimor i shkencave të edukimit, grupi kërkimor për studime fetare, grupi kërkimor i mësimin të gjuhës angleze si gjuhë e dytë, të cilat janë riorganizuar sipas interesave në fushën e kërkimit, por dhe lëvizjeve të personelit.

Në këtë aspekt, Kolegji Universitar "Bedër" dhe konkretisht departamenti i shkencave të komunikimit, ka përfunduar me sukses projektin "Sfidat e transmetuesve lokalë dhe rajonalë përballë qasjes online të shërbimeve të tyre". Projekti filloi dhe u krye në bashkëpunim dhe me financim të Autoritetit të Medieve Audiovizive, duke u realizuar nëpërmjet intervistave, organizimit të seminareve, konferencave shkencore dhe publikimit të gjetjeve, rezultateve dhe rekomandimeve të këtij kërkimi në një dokument shkencor përmbledhës.

Kolegji Universitar "Bedër" është pjesë si partner në projektin "Strengthening Civil Society to Build Youth Resilience to Violent Extremism" (Funded EuropeAid / 152207 / DD / ACT / AL) drejtuar nga Terre des Homme. Projekti synon të kontribuojë në sigurimin e pjesëmarrjes aktive

të shoqërisë civile në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së të rinjve. Kolegji Universitar “Bedër” përfshihet në të te pjesa e studimit ku vlerësohen materialet e grumbulluara përmes një analize të situatës në tri komunitat e përfshira, duke sjellë një përfundim themelor për financuesit të granteve. Në të njëjtën kohë, studimet e ndërmarra gjatë realizimit të programit do të kenë ndikimin e tyre praktik në kundërshtimin e strategjive dhe praktikave të ekstremizmit të dhunshëm. Rezultatet e kërkimit do të shpërndahen tek institucionet kyçe të përfshira në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm.

Plani strategjik i Kolegji Universitar “Bedër” parashikon tri elemente të rëndësishme për funksionimin e aktivitetit institucional: mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe kontributin në shoqëri. Në këtë këndvështrim, rëndësi e veçantë i kushtohet pranimit të studentëve cilësorë, cilësisë së mësimin, cilësisë së kërkimit shkencor dhe mbështetjes së inovacionit.

Kërkimi shkencor ka qenë në themel të procesit akademik në Kolegjin Universitar “Bedër”, ku gjatë viteve akademike i gjithë personeli ka qenë i angazhuar në punë kërkimore. KUB ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Në organizimet e konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare, Kolegji Universitar “Bedër” ka mbështetur pjesëmarrjen e studiuesve të rinj, veçanërisht të doktorantëve. Në kuadër të marrëdhënieve që ka ndërtuar me MASR, Kolegji Universitar “Bedër” zbaton politikat shkencore rajonale dhe kombëtare duke i konkretizuar me aktivitete të realizuara dhe të tjera që planifikohen të mbahen në vijim. Ky institucion i arsimit të lartë ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj dhe për këtë arsye ka punësuar pedagogë të huaj nga disa shtete të ndryshme të botës, si: Turqia, SHBA, Anglia, Gjermania, Spanja, Kosta Rika dhe Kosova. Kolegji Universitar “Bedër” me anë të udhëzimit për nxitjen e publikimeve dhe të kërkimit shkencor, mbështet pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, angazhimin në projekte kërkimore, por edhe shpërblen arritjet akademike vjetore për indikatorë transparentë të parashikuar në rregulloren përkatëse. Marrëveshjet që ka me universitetet partnere të projektit “Mevlana”, “Erasmus+” kanë mbështetur shkëmbimin e personelit akademik dhe të studentëve.

Gjithashtu, institucioni punon ngushtë me agjencitë kombëtare të kërkimit shkencor dhe inovacionit. Në këtë drejtim, Kolegji Universitar “Bedër” ka nënshkruar kartën për studiuesit evropianë, në përputhje me orientimin e AKTI. Personeli akademik është trajnuar nga AKTI në drejtim të zbatimit të projekteve dhe të programit “Horizont 2020”. Kolegji Universitar “Bedër” aplikon në mënyrë të vazhdueshme në projekte kërkimore në përgjigje të thirrjeve për aplikime në projekte hulumtuese-shkencore në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Duke parë interesin dhe përfshirjen e vazhdueshme të studentëve në konkurset e ndryshme gjatë realizimit të temave të diplomave në ciklin e parë të studimeve “Bachelor” apo të tezave të ciklit të dytë “Master”, gjatë projekteve të organizuara si pjesë e programeve mësimore, si dhe pjesëmarrjen aktive në konferenca studentore të organizuara nga Kolegji Universitar “Bedër”, por edhe jashtë tij, me vendim të Senatit Akademik ka mbështetur “Qendrën për kërkuesit e rinj”. Qendra ka për qëllim t’u ofrojë studentëve një mundësi unike për të qenë pjesë e veprimtarisë kërkimore të institucionit, si dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në

fushën e kërkimit shkencor. KUB fton personel akademik të jashtëm të marrë pjesë në mësimdhënie në formën e leksioneve të hapura, si dhe në angazhime me kohë të pjesshme.

Në mbështetje të mbarëvajtjes së procesit akademik, Kolegji Universitar “Bedër” ka vënë në dispozicion të studentëve dhe personelit bibliotekën e institucionit, e cila ofron një gamë të gjerë prej 36000 titujsh, të përzgjedhur sipas programeve të studimit të ofruara. Njëherazi mundëson shfrytëzimin e bibliotekës online **EbscoHost**, prej nga studentëve u afrohet përdorimi në mbi 45000 libra dhe mbi 5000 revista shkencore.

Me qëllim ndjekjen dhe vlerësimin e ecurisë së kërkimit shkencor, pranë Kolegji Universitar “Bedër” funksionon zyra e kërkimit shkencor, e cila harton dhe administron politikat që rregullojnë zhvillimin e kërkimeve në Kolegji Universitar “Bedër”, mbikëqyr zbatimin e programeve të tij të kërkimit, duke synuar të përmirësojë produktivitetin kërkimor të institucionit dhe të zgjerojë ndikimin e rezultateve akademike të kërkimit në drejtim të rretheve akademike dhe komunitetit. Zyra e kërkimit shkencor shërben si organ koordinues ndërmjet institucioneve donatore dhe institucionit, mbështet institucionin dhe personelin akademik lidhur me informacionin mbi thirrjet e hapura për projekte dhe financime, si dhe aspektet teknike të procedurave të aplikimit

Ndër politikat e rëndësishme të Kolegjit Universitar “Bedër” është nxitja e personelit akademik të institucionit që të publikojnë punët e tyre kërkimore në revista shkencore ndërkombëtare, në përfundim të të cilave ofrohet dhe një ndihmesë financiare. Duke e mbështetur këtë aktivizim të ekipit akademik, kjo ka sjellë frytet e saj duke bërë që aktualisht personeli të ketë botuar mbi 400 artikuj shkencorë etj. Varësisht nevojave të programeve akademike, Kolegji Universitar “Bedër” ofron mjedise që ndihmojnë studentin për formimin praktik dhe profesional. Të tilla janë qendra e medias dhe komunikimit, laboratorit i gjuhëve të huaja, laboratorit i kompjuterave, salla e gjyqit imitues etj.

Gjithashtu Kolegji Universitar “Bedër” merr pjesë në projektin e mëposhtëm:

“Scholas Occurrentes”, i cili është një iniciativë që synon të rinjtë në botë, fton të integrojnë në të studentët e universiteteve publike dhe private, të të gjitha besimeve fetare, për të edukuar të rinjtë në angazhimin për të mirën e përbashkët. “Scholas” është një organizatë ndërkombëtare e nxitur nga Papa Francisco që bashkëpunon me Kolegjin Universitar “Bedër” dhe komunitetet arsimore, publike dhe private, fetare dhe sekulare për të vendosur dhe mbajtur gjallë paktin arsimor. Si një organizatë e shoqërisë civile, kërkon angazhimin e të gjithë aktorëve për të zbatuar kulturën e paqes përmes veprimtarive rinore.

2.2.2 KËRKIMI SHKENCOR NË INSTITUCION

Duke pasur parasysh ndërlidhjen e kërkimit shkencor me mësimin, studentët janë mbështetur vazhdimisht të përfshihen në punë kërkimore-shkencore me qëllim nxitjen dhe kultivimin e kulturës së kërkimit gjatë viteve të jetës së tyre universitare, në mënyrë që të mund të fillojnë karrierën e tyre profesionale të mirëpërgatitur me ide dhe aftësi novatore.

Në këtë kuadër, “Qendra për kërkuesit e rinj”, u ofron studentëve një mundësi të shtuar për të qenë pjesë e veprimtarisë kërkimore të institucionit apo jashtë tij, si dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në fushën e kërkimit shkencor.

Në të njëjtën kohë, studentët e departamentit të drejtësisë vijojnë të përfaqësohen denjësisht në dy konkurse ndërkombëtare, përkatësisht:

JESSUP - Philip C. Jessup, Konkursi Ndërkombëtar i Gjyqit Imitues, një konkurs advokimi për studentët e drejtësisë, ku ekipet e studentëve konkurrojnë përballë njëri-tjetrit përmes paraqitjes me gojë dhe me shkrim duke trajtuar çështje të së drejtës ndërkombëtare publike në kontekstin e një konflikti ligjor hipotetik mes shteteve.

Konkursi i Gjyqit Imitues në Gjykatën Ndërkombëtare Penale, që zhvillohet çdo vit në Hagë, Holandë. Konkursi mirëpret universitetet nga e gjithë bota për një gjyq imitues që simulon procedimet e Gjykatës Ndërkombëtare Penale (ICC).

AKTIVITETE SHKENCORE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

- 1. Emri i aktivitetit:** Konferenca e Tretë Ndërkombëtare në Studimet Islame “Sfidat e myslimanëve në shoqërinë e shekullit XXI”

Organizatorë: KMSH, Kolegji Universitar “Bedër”

Periodiciteti: 1 herë në vit

Edicioni i parë: Mars 2018

Personi i kontaktit: Dr. Genti Kruja; email: gkruja@beder.edu.al

Financues: KU “Bedër”.

Botimi i referimeve shkencore të aktivitetit: Po.

Linku në internet për aktivitetin: ëëë.beder.edu.al

- 2. Emri i aktivitetit:** Konferencë Studentore

Organizatorë: Kolegji Universitar “Bedër”

Periodiciteti: 1 herë në vit

Edicioni i parë: Shkurt 2018

Personi i kontaktit: Msc. Hysni Skura; email: hskura@beder.edu.al

Financues: KU Bedër.

Botimi i referimeve shkencore të aktivitetit: Jo.

Linku në internet për aktivitetin: ëëë.beder.edu.al

3. Emri i aktivitetit: Simpoziumi i nëntë ndërfetar

Organizatorë: Kolegji Universitar “Bedër”, Departamenti i Shkencave Islame

Periodiciteti: 2 herë në vit

Edicioni i parë: Dhjetor 2015

Personi i kontaktit: Dr. Genti Kruja; email: gkruja@beder.edu.al

Financues: KU “Bedër”.

Botimi i referimeve shkencore të aktivitetit: Jo.

Linku në internet për aktivitetin: ëëë.beder.edu.al

4. Emri i aktivitetit: Konferenca Ndërkombëtare mbi edikimin fetar në shkollat e Evropës

Organizatorë: Universiteti i Vjenës

Periodiciteti: -

Edicioni i parë: janar 2019

Personi i kontaktit: Dr. Genti Kruja; email: gkruja@beder.edu.al

Financues: Ambasada e Austrisë.

Botimi i referimeve shkencore të aktivitetit: Po.

Linku në internet për aktivitetin: ëëë.beder.edu.al

PUBLIKIMET E PERSONELIT AKADEMIK

	Emërtimi i revistës shkencore ku janë publikuar botimet e kollonave 1 dhe 2	Artikuj Shkencorë	2 Publikime në proceedings	Fusha e publikimit (zgjidh një numër të një nga opsioneve në fund të tabelës)	Botim i shtypur/ open access journals
1	Fatiola NELAJ, PhD. Arti OMERI, The importance of fluency and accuracy in promoting english as a foreign language		Beder Journal of Humanities		
2	MA Ana Bendo & Dr. Isa Erbas, Teaching English Through Games, http://journals.euser.org/index.php/ejls/article/view/4743		European Journal of Language and Literature Studies, Volume 6, Issue 2,		
3	Dr. Isa Erbas & MA. Vjollca Hysa, Teaching 1st Year Students by Using Inquiry Method (Case Study, Memorial International School of Tirana), http://journals.euser.org/files/articles/ejed_v2_i3_19/Erbas.pdf		European Journal of Education, Volume 2, Issue 3.		
3	Dr. Isa Erbas & MA. Xhensika Vengo, Language Through Communicative Activities in Upper-Level Students (Case Study: “Turgut Ozal” High School Tirane), http://journals.euser.org/files/articles/ejls_v5_i2_19/Erbas.pdf		European Journal of Language and Literature Studies Volume 5, Issue 2		

4	Dr. Isa Erbas, Ergyst Shehu, “A study of methods, approaches, and models of teaching English grammar to EFL students: A case of “Mehmet Akif” Colleges” Tirana, Albania, 5.9 (B+), http://euacademic.org/UploadArticle/3939.pdf		European Academic Research Vol. VII, Issue 1/ Impact Factor: 3.4546 (UIF) DRJI Value:		
5	Dr. Enriketa Sogutlu, The Use of L1 in Teaching English to Young Learners		Journal		
6	Dr. Sofokli Garo, Contribution of educational resources at Albanian students’ homes towards their learning of mathematics.		This article is written in the context of the study of the mathematics results of Eastern Balkan countries in 2015, 2018 PISA competitions		
7	MSc. Gentjan Skara, The Rocky Road of Eastern Balkan Countries Towards European Integration: The Need for a Credible and Effective Approach			EU Enlargement	Journal of European Social Research (JESR)
8	Dr. Ferdinand Xhaferaj & MSc. Gentjan Skara, Local Public Participation in Albania: Actions and Reflections after the 2014 Reform on Local Self-Government, dhjetor 2020				OLA Conference publication

9	Dr. Genti Kruja, Një këndvështrim sociologjik i familjes në Islam, mars 2020		Konferenca e III-të në Studimet Islame, ISCON III	Sociologji Islame	
10	Dr. Genti Kruja, Interfaith Dialogue in Albania as a Model of Interreligious Harmony, gusht 2020	Scopus, http://dx.doi.org/10.29333/ejecs/377		Sociologji	Journal of Ethnic and Cultural Studies
11	Dr. Genti Kruja, Bashkëjetesa ndërfaqetare ndër shqiptarë, si faktor stabiliteti social, 2019	Takvim		Sociologji	

*Për shkak të pandemisë Covid-19, shumica e aktiviteteve shkencore të planifikuara nga Kolegji Universitar “Bedër” janë anuluar.

Pjesëmarrja e stafit në projekte ndërkombëtare dhe mbështetje për lëvizshmërinë e tyre

Gjatë viteve akademike duke filluar nga 2011-2012 deri në vitin akademik 2019-2020, KU “Bedër” ka organizuar rreth 26 konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare në bashkëpunim me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, anëtarët e personelit akademik të KU B kanë marrë pjesë në veprimtari të rëndësishme jashtë vendit. Me institucionet arsimore të huaja, me të cilat institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, ndjek një politikë favorizuese për lëvizshmërinë e personelit akademik dhe të studentëve, organizimin e konferencave ndërkombëtare, të projekteve të përbashkëta kërkimore, trajnimeve profesionale dhe praktikave studentore. KU “Bedër”, duke synuar të ndjekë një politikë integruese për personelin akademik të ftuar dhe të studiuesve të huaj, ka punësuar pedagogë të huaj nga shtete të ndryshme të botës, si: Turqia, SHBA, Anglia, Gjermania, Spanja, Kosta Rika dhe Kosova. Një pjesë e profesorëve të ftuar kanë ardhur në kuadër të marrëveshje të bashkëpunimit me universitete të ndryshme.

Departamenti i Shkencave Islame është bërë pjesë e një programi studimi “Master” prej një bashkëpunimi me Institutin e Lartë të Studimeve Religjioze në Rimini të Italisë dhe në bashkëpunim me Shkollën e Lartë të Studimeve Historike në Universitetin e Republikës së San Marinos. Partneriteti i disa institucioneve akademike ndërkombëtare ka bërë të mundur hapjen për herë të parë të një programi studimi pasuniversitar mbi Dialogun Ndërfetar dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare.

Ky partneritet i Departamentit të Shkencave Islame, vjen pas pjesëmarrjes së tij në një konferencë ndërkombëtare, mbajtur në tetor 2018 dhe organizuar nga Instituti i Lartë i Studimeve Religjioze në lidhje me modelin shqiptar të dialogut ndërfetar. Pas kësaj konference, Instituti në fjalë, ka ftuar zyrtarisht Departamentin e Shkencave Islame në KUB për të qenë partner i një programi pasuniversitar, i cili do të realizohej në bashkëpunim me Universitetin e San Marinos. Partnerë të këtij programi janë gjithashtu dhe disa institucione fetare dhe akademike kryesisht nga Italia dhe Shqipëria, të cilët po japin një kontribut në zhvillimin e dialogut ndërfetar.

Në përfundim të këtij programi 2-vjeçar (2018-2020), Instituti i Lartë i Studimeve Religjioze i ka dërguar një letër falënderimi Departamentit të Shkencave Islame, “Bedër” për bashkëpunimin si partner i këtij programi.

Ky program synon një vështrim objektiv të fenomenit fetar, së bashku me historikun dhe krahasimin e kulturave të ndryshme fetare. Ai ka qëllim të shtjellojë një kulturë të themeluar epistemologjikisht të dialogut ndërfetar dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Kjo rrugë akademike i kushton vëmendje të veçantë zonës së Ballkanit dhe Mesdheut, për të favorizuar një zhvillim inovativ dhe konkret të rrjeteve të solidaritetit, për të promovuar paqen dhe bashkëjetesën ndërfetare dhe ndërkulturore.

Programi ka gjithsej 60 ECTS (kredi universitare), i barasvlefshëm me një “Master” universitar të nivelit të parë dhe ndër të tjera synon të eksplorojë format antropologjike, kulturore, gjuhësore, filozofike, teologjike dhe mistike të traditave të ndryshme fetare, në mënyrë që të kuptojë më thellë rrënjët e civilizimeve të ndryshme dhe identitetet kulturore, zhvillimin e tyre historiko-politik, përhapjen dhe ndikimin e tyre, etj.

Programi vlen kryesisht për të diplomuarit në:

Shkencat Teologjike

Të diplomuar dhe doktorantë në disiplinat *Histori e feve* dhe *Filozofi e feve*

Të diplomuar dhe studentë të doktoraturës në disiplina juridike, marrëdhënie ndërkombëtare, histori të doktrinave politike dhe të ngjashme

Të diplomuar dhe doktorantë në letërsi, filozofi dhe shkenca politike

Diplomantë të rinj nga e gjithë Ballkani dhe zona e Mesdheut

Operatorët në fushën e dialogut ndërfetar

Operatorët e marrëdhënieve ndërkombëtare, mësuesit e profileve të ngjashme, etj.

Vëmendje e veçantë i kushtohet edhe profileve të mëposhtme profesionale, si:

Studiuesit në shkencat fetare, që punojnë në universitetet evropiane dhe në vendet e zonave të Ballkanit dhe Mesdheut

Anëtarët e Korpusit Diplomatik dhe Konsullor të vendeve evropiane, zonës së Ballkanit dhe Mesdheut

Ekspertë dhe konsulentë ndërkombëtarë në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, politikave kulturore dhe integritit shoqëror

Edukatorë dhe mësues të specializuar në fushën e trajnimit/edukimit në dialog ndërfetar dhe ndërkulturor

Studiues dhe akademikë të rinj universitarë

Mësuesit e shkollave fetare;

Ekspertë të komunikimit në sektorin ndërfetar dhe ndërkulturor, etj.

Programi i titulluar “Dialog ndërfetar dhe marrëdhënie ndërkombëtare” është i sponsorizuar dhe i akredituar nga Fakulteti Teologjik i Emilia Romagna dhe njihet dhe nga Ministria e Arsimit e Italisë.

Faqja e programit:

<https://www.issrmarvelli.it/corsi/corso-di-alta-formazione-in-dialogo-interreligioso-e-relazioni-internazionali/>

Në datat 15-17 nëntor 2019 është mbajtur në Universitetin e Vjenës në Austri, Konferenca Ndërkombëtare “Feja në shkolla”.

Konferenca e iniciuar nga Instituti i Teologjisë Islame në Universitetin Vjenës është mbajtur në ambientet e kampusit universitar të këtij universiteti, ku merrnin pjesë me kumtesa mbi 30 akademikë nga universitete të ndryshme të botës. Në seancën e hapjes ishin të ftuar specialë ish-ministri i Arsimit të Austrisë z. Heinz Fassmann, Prof. Almeda Erigh nga Universiteti Yale dhe Prof. Lauren Kerby nga Universiteti Harvard, SHBA.

Në këtë tubim shkencor ku ishte i ftuar dhe KUB, mori pjesë Dr. Genti Kruja, përgjegjës i Departamentit të Shkencave Islame dhe z. Ali Zaimi, drejtor i përgjithshëm i medresesë së Tiranës, por dhe lektor në këtë departament.

Në kumtesën e tyre “Sfidat e edukimit fetar në shkolla në shoqëritë multifetare: Rasti i Shqipërisë”, kumtuesit kanë informuar rreth historikut të edukimit fetar në Shqipëri, lëndës së edukimit fetar në vitet 20-30 të shekullit XX dhe sfidave të saj sot, persekutimit dhe ndalimit të fesë gjatë periudhës së komunizmit, ringritjen e institucioneve fetare dhe atyre arsimore në varësi të tyre pas viteve '90, si kontributin e komuniteteve fetare në arsim në shoqërinë shqiptare.

Ata kanë dhënë gjithashtu detaje të hollësishme rreth historikut të arsimit Islam në Shqipëri, medreseve dhe Departamentit të Shkencave Islame, institucione arsimore, të cilat prej vitesh

kanë diplomuar mijëra nxënës dhe studentë, të edukuar me frymën e bashkëjetesës në një shoqëri multifetare si ajo në Shqipëri dhe me gjerë.

Studiues dhe akademikë të ardhur nga universitete të ndryshme të botës kanë folur po ashtu rreth sfidave dhe realitetit të edukimit fetar, në vendin nga i cili ata vinin.

Kjo konferencë vjen pas konferencës së janarit të këtij viti, ku merrnin pjesë 50 akademikë dhe drejtues të departamenteve, fakulteteve dhe instituteve teologjike islame nga e gjithë Evropa.

Më poshtë janë listuar lektorët e Kolegjit Universitar “Bedër” që kanë kryer shkëmbim përvojash akademike në universitete të ndryshme:

Nr.	Emri i Stafit të Shkëmbyer	Institucioni pritës
1	Dr. Erlis Cela	Ohio University/ Michigan University
2	Dr. Nertil Berdufi	Loyola University Chicago
3	Msc. Gentjan Skara	Graz University
5	Prof.Asoc.Dr. Tidita Abdurrahmani	Sakarya University/ Graz University
6	Assoc. Prof. Dr. Rahim Ombashi	Sakarya University
7	Bledar Uku	Middle East Technical University
8	Prof. Dr. Ferdinand Gjana	Ohio University
9	Dr. Arti Omeri	Neë York University

2. TË DHËNA MBI PROGRAMET E STUDIMIT

2.1 PROGRAMET E STUDIMIT TË OFRUARA DHE PROGRAMET E STUDIMIT NË PROCES LICENCIMI

Në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 286, datë 6.04.2011 “Për licencimin e Shkollës së Lartë Private “Hëna e Plotë” (Bedër) dhe me urdhrat e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës nr. 534 dt: 27.10.2011, nr. 18 dt.: 19.01.2012, nr. 10 dt.: 16.1.2012, nr. 218 dt.: 28.05.2012, nr. 330 dt.: 07.08.2012, nr. 404 dt.: 12.07.2018 dhe nr.426 dt.: 18.07.2018 janë hapur këto programe studimi me kohë të plotë:

Ciklit i parë të studimeve

“Bachelor” në:

Drejtësi;

Shkenca komunikimi;

Shkenca islame;

Gjuhë dhe letërsi angleze;

Arsim parashkollor dhe fillor;

Psikologji këshillimi dhe pedagogji.

Marrëdhënie publike dhe komunikim marketingu

Teknologji informacioni dhe komunikimi

Shkenca kompjuterike

Cikli i dytë i studimeve:

“Master profesional” në:

Mësuesi, gjuhë angleze për arsimin e mesëm;

Komunikim marketingu

“Master i shkencave” në:

Drejtësi, profili: E drejtë penale / profili: E drejtë ndërkombëtare;

Shkenca komunikimi: profili: Marrëdhënie me publikun / profili: Gazetari;

Shkenca moderne islame;

Shkenca themelore islame;

Psikologji këshillimi dhe pedagogji;

Gjuhë dhe letërsi angleze.

2.2 PËRSHTATSHMËRIA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME MISIONIN E INSTITUCIONIT DHE LIDHJA ME TREGUN E PUNËS

Programet e studimit të ofruara nga Kolegji Universitar “Bedër” janë në përputhje të plotë si me kërkesat aktuale të tregut të punës, ashtu edhe me zhvillimet e pritshme të ekonomisë shqiptare si një ekonomi në zhvillim, e cila synon integrimin në tregun evropian.

Kurrikulat bashkëkohore të Kolegjit Universitar “Bedër” synojnë të përgatisin:

Jurist\specialist në institucionet e administratës publike (qendrore/vendore); jurist\specialist në institucione ndërkombëtare; jurist\specialist\konsulent ligjor në sektorin privat; asistent avokat\asistent noter si dhe kualifikim për pjesëmarrje në provimin e avokatisë; asistent kërkimor\mësimor pranë IAL.

Specialistë të kualifikuar për administratën e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë (KMSH) në qendër dhe bazë, si dhe mësues për institucionet e arsimit 9-vjeçar e të mesëm në varësi të KMSH-së.

Specialistë dhe profesionistë të shkencave të komunikimit, të kualifikuar në fushën e gazetarisë, të komunikimit dhe të marrëdhënieve publike apo dhe në fusha të ngjashme me to, të aftë për tregun e punës në kushtet e një shoqërie globale që shpejton në kapjen dhe zbatimin e teknologjive moderne, që kanë përfshirë fushën e komunikimit e të medias.

Mundësitë e punësimit pas diplomimit përfshijnë aftësi pedagogjike drejtuese për të aplikuar në institucione të ndryshme. Studentët do të jenë të aftë të punësohen si edukatore dhe mësues. Gjithashtu ata do të fitojnë aftësi të ndryshme në drejtimin pedagogjik dhe psikologjik, të cilat mund t’i zbatojnë në institucione të ndryshme private ose publike.

Pas diplomimit, studentët mund të vazhdojnë studimet e tyre të doktoraturës, ose studime pasuniversitare në Shqipëri ose jashtë vendit. Ata gjithashtu mund të bëhen lektorë në universitete, koordinatorë konferencash, projektsh etj. Ky program i mundëson studentët të pajisen me aftësi dhe njohuri të ndryshme. Ai gjithashtu i mëson ata si të lehtësojnë marrëdhëniet personale dhe ndërpersonale në përgjithësi. Studentët do të kenë gjithashtu mundësi të punësohen në institucione të ndryshme edukimi, të cilat mund të përmbajnë menaxhim, planifikim apo zhvillim kurrikule.

Studenti pasi të ketë kryer specializimet përkatëse mund të punojë si përkthyes ose editor në media dhe shtëpi botuese, gjithashtu mund të punojë edhe si kërkues shkencor në fushën e dokumentacionit në osmanisht.

Studenti pasi të ketë kryer specializimet përkatëse mund të punojë si mësues gjuhe dhe letërsie në arsimin fillor, gjithashtu në shkollë të mesme dhe mësues në qendra të ndryshme kursesh. Studenti mund të komunikojë rrjedhshëm në nivele akademike si me shkrim ashtu edhe me gojë me folësit amtarë dhe joamtarë të gjuhës turke; të përkthejë tekste të ndryshme, të shpalojë lehtësi komunikimi mes palëve turqishtfolëse dhe joturqishtfolëse.

REALIZIMI I SYNIMEVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT NËPËRMJET MBULIMIT ME PERSONELIN AKADEMIK TË PËRSHTATSHËM

Gjatë vitit akademik 2019-2020 në Kolegjin Universitar “BEDËR” janë angazhuar 93 pedagogë (efektivë dhe joefektivë) për 634 studentë. Raporti është rreth 7 studentë / pedagogë, duke mundësuar punën intensive me studentët për të mbështetur dhe monitoruar nga afër rritjen e tyre cilësore dhe profesionale, vit pas viti.

Ky raport tregon rëndësinë që institucioni i jep raportit student-pedagog, duke ruajtur kështu jo vetëm raportin, por duke rritur ndjeshëm edhe cilësinë.

Objektivi i Kolegjit Universitar “BEDËR” në këtë drejtim është dhe do të mbetet gjithmonë tërheqja e personelit të kualifikuar, kryesisht me grada dhe tituj shkencorë, standard i përcaktuar në strategjinë e zhvillimit të institucionit. Për të plotësuar nevojat për pedagogë të kualifikuar kemi zgjedhur të kombinojmë punësimin e profesionistëve vendas dhe të huaj me eksperiencë në fushën akademike.

Personeli akademik 2019 – 2020

FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE						
Nr	Titulli	Emër	Mbiemër	Fusha kërkimore	Pozicioni	Kohë e plotë / Kohë e Pjesëshme
	Prof.Asoc. Dr.	Rahim	Ombashi	Gjuhë Letërsi	Dekan (Departamenti i Shkencave Islame)	Kohë e plotë
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE ISLAME						
	Dr.	Genti	Kruja	Sociologji	Përgjegjës departamenti	Kohë e plotë
	Dr.	Sadullah	Yilmaz	Gjuhë turke	Lektor	Kohë e plotë
	Msc.	Elton	Karaj	Shkenca Islame	Asistent Lektor	Kohë e plotë
	Msc.	Hysni	Skura	Shkenca Islame	Asistent Lektor	Kohë e plotë

	Msc.	Lorela	Sula	Shkenca Islame	Asistent Lektor	Kohë e plotë
	Msc.	Xhorxhina	Seferi	Shkenca Islame	Asistent Lektor	Kohë e plotë
	Dr.	Hasan	Bello	Histori	Lektor	Kohë pjeshme
	Dr.	Ilirjana	Kaceli	Histori	Lektor	Kohë pjeshme
	Msc.	Skënder	Bruçaj	Psikologji	Asistent lektor	Kohë pjeshme
	Msc.	Ali	Zaimi	Gazetari	Asistent lektor	Kohë pjeshme
	Msc.	Aorel	Senja	Shkenca Islame	Asistent lektor	Kohë pjeshme
	Msc.	Ledian	Cikalleshi	Shkenca Islame	Asistent lektor	Kohë pjeshme
	Msc.	Valdrin	Mera	Shkenca Islame	Asistent lektor	Kohë pjeshme

DEPARTAMENTI I SHKENCAVE TE KOMUNIKIMIT

	Dr.	Erlis	Çela	Komunikim	Përgjegjës i departamentit	Kohë e plotë
	Dr.	Ana	Kekezi	Komunikim	Lektor	Kohë e plotë
	Dr.	Ardita	Reçi	Komunikim	Lektor	Kohë e plotë
	Dr.	Ndricim	Çiroka	Ekonomi-Agrobiznes	Lektor	Kohë e plotë
	Dr.	Valmora	Gogo	Komunikim	Lektor	Kohë e plotë
	Msc.	Edlira	Mali	Marketing-Menaxhim	Asistent lektor	Kohë e plotë
	Msc.	Emirjon	Senja	Komunikim	Asistent lektor	Kohë e plotë
	Msc.	Rudi	Dunga	Komunikim	Asistent lektor	Kohë e plotë
	Msc.	Jola	Marku	Komunikimi	Asistent lektor	Kohë e plotë

	Msc.	Norga	Sulo	Komunikimi	Asistent lektor	Kohë e plotë
	Dr. Doc.	Ramadan	Cipuri	Komunikim	Lektor	Kohë pjesëshme
	Prof. Asoc. Dr	Mark	Marku	Komunikim	Lektor	Kohë pjesëshme
	Msc.	Fatos	Hakorja	Komunikim	Lektor	Kohë pjesëshme
	Dr.	Irena	Myzeqari	Komunikim	Asistent lektor	Kohë pjesëshme
	Msc.	Suela	Tuci	Administrim	Asistent Lektor	Kohë pjesëshme
	Dr.	Anxhela	Hoxha	Art	Lektor	Kohë pjesëshme
	Msc.	Mentor	Kikia	Komunikim	Asistent lektor	Kohë pjesëshme
DEPARTAMENTI DREJTËSI						
	Prof. Dr.	Ferdinand	Gjana	Shkenca politike, marrdhënie ndërkombëtare	Rektor	Kohë e plotë
	Dr.	Ferdinand	Xhaferaj	Shkenca politike marrëdhënie ndërkombëtare	Përgjegjës i departamentit	Kohë e plotë
	Dr.	Bojana	Hajdini	E drejtë penale	Lektor	Kohë e plotë
	Dr.	Nertil	Berdufi	E drejtë penale	Lektor	Kohë e plotë
	Dr.	Gentian	Skara	E drejtë evropiane	Lektor	Kohë e plotë
	Msc.	Surja	Shehi	Mjekësi ligjore	Asistent lektor	Kohë e plotë
	Msc.	Ermira	Shkreta	E drejtë romake	Asistent lektor	Kohë e plotë
	Msc.	Bledar	Uku	E drejtë publike	Asistent lektor	Kohë e plotë

	Msc.	Ermira	Bushi	E drejtë penale, Histori Institucionesh	Asistent lektor	Kohë e plotë
	Msc.	Aranit	Qinami	E drejtë civile	Asistent lektor	Kohë e plotë
	Prof. Dr.	Altin	Shegani	E drejtë penale	Lektor	Kohë e pjeshme
	Prof.Asoc. Dr	Ervin	Pupe	E drejtë civile	Lektor	Kohë e pjeshme
	Dr.	Xhavit	Shala	Siguri kombëtare	Lektor	Kohë e pjeshme
	Dr.	Adnan	Xholi	E drejtë penale	Lektor	Kohë e pjeshme
	Dr.	Admir	Belishta	E drejtë penale	Lektor	Kohë e pjeshme
	Dr.	Bojana	Hajdini	E drejtë penale	Lektor	Kohë e pjeshme
	Msc.	Livia	Rokaj	E drejtë civile	Asistent lektor	Kohë e pjeshme
	Msc.	Enkelejd	Alibeaj	E drejtë publike	Asistent lektor	Kohë e pjeshme
	Msc.	Fatri	Islamaj	E drejtë tregtare	Asistent lektor	Kohë e pjeshme
	Msc.	Besmira	Petriti	E drejtë publike	Asistent lektor	Kohë e pjeshme
	Msc.	Ada	Guven	E drejtë publike	Asistent lektor	Kohë e pjeshme
	Msc.	Suela	Ndreca	E drejtë civile	Asistent lektor	Kohë e pjeshme
	Msc.	Ermal	Mema	E drejtë biznesi	Asistent lektor	Kohë e pjeshme

FAKULTETI I FILOLOGJISË DHE EDUKIMIT

Nr	Titulli	Emër	Mbiemër	Fusha kërkimore	Pozicioni	Kohë e plotë / Kohë e Pjeshme
----	---------	------	---------	-----------------	-----------	-------------------------------

	Prof. Asoc. Dr.	Tidita	Abdurrahmani	Gjuhë Angleze	Letërsi	Dekan (Departamenti i Shkencave të Edukimit)	Kohë e plotë
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT							
	Dr.	Ana	Uka	Shkenca Edukimi		Përgjegjës departamenti	Kohë e plotë
	Dr.	Irena	Shehu	Pedagogji		Lektor	Kohë e plotë
	Dr.	Jonida	Tirana	Shkenca edukimi		Lektor	Kohë e plotë
	Msc.	Erilda	Ajaz	Shkenca edukimi		Asistent lektor	Kohë e plotë
	Msc.	Eduina	Maksuti	Shkenca edukimi		Asistent lektor	Kohë e plotë
	Msc.	Klevis	Topi	Shkenca edukimi		Asistent lektor	Kohë e plotë
	Msc.	Elvira	Baze	Shkenca edukimi		Asistent lektor	Kohë e pjesshme
	Msc.	Ornela	Tabaku	Shkenca edukimi		Asistent lektor	Kohë e pjesshme
	Msc.	Aida	Docci	Matematikë		Asistent lektor	Kohë e pjesshme
	Msc.	Uejda	Kadria	Shkenca edukimi		Asistent lektor	Kohë e pjesshme
DEPARTAMENTI I GJUHËS DHE LETËRSISË ANGLEZE							
	Dr.	Arti	Omeri	Gjuhë dhe letërsi angleze/Pedagogji		Përgjegjës i departamentit	Kohë e plotë
	Dr.	Isa	Erbas	Gjuhë dhe letërsi angleze		Lektor	Kohë e plotë
	Dr.	William	Martin	Gjuhë dhe letërsi angleze		Lektor	Kohë e plotë
	Dr.	Enriketa	Sogurtlu	Gjuhë dhe letërsi angleze		Lektor	Kohë e plotë
	Msc.	Zamira	Hodo	Gjuhë dhe letërsi angleze		Asistent Lektor	Kohë e plotë
	Msc.	Albana	Cekrezi	Gjuhë dhe letërsi angleze		Asistent Lektor	Kohë e plotë
	Msc.	Temisa	Isufi	Gjuhë dhe letërsi angleze		Asistent Lektor	Kohë e plotë
	Msc.	Indrit	Lami	Gjuhë dhe letërsi angleze		Asistent Lektor	Kohë e plotë
	Dr.	Emilda	Roseni	Gjuhë dhe letërsi angleze		Lektor	Kohë e pjesshme

	Dr.	Anita	Neziri	Gjuhë dhe letërsi angleze	Lektor	Kohë e pjeshme
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE						
	Dr.	Sofokli	Garo	Matematikë	Përgjegjës departamenti	Kohë e plotë
	Dr.	Nihat	Aksu	Shkenca edukimi	Lektor	Kohë e plotë
	Dr.	Mehmet	Aslan	Shkenca edukimi	Lektor	Kohë e plotë
	Msc.	Krisien	Xoxa	Shkenca kompjuterike	Asistent lektor	Kohë e plotë
	Msc.	Edlir	Spaho	Shkenca kompjuterike	Asistent lektor	Kohë e plotë
	Msc.	Uran	Kalej	Sociologji	Asistent lektor	Kohë e plotë
	Msc.	Alma	Hyra	Shkenca kompjuterike	Asistent lektor	Kohë e plotë
	Msc.	Fezi	Shaholli	Fizikë	Asistent lektor	Kohë e plotë
	Dr.	Irma	Berdufi	Fizikë	Lektor	Kohë e pjeshme
	Dr.	Anjeza	Pasku	Shkenca kompjuterike	Lektor	Kohë e pjeshme
	Dr.	Artur	Koci	Shkenca kompjuterike	Lektor	Kohë e pjeshme
	Msc.	Anxhela	Gjecka	Shkenca kompjuterike	Asistent lektor	Kohë e pjeshme
	Msc.	Armand	Agolli	Shkenca kompjuterike	Asistent lektor	Kohë e pjeshme
	Msc.	Alban	Deda	Shkenca kompjuterike	Asistent lektor	Kohë e pjeshme
	Msc.	Rexhion	Qafa	Shkenca kompjuterike	Asistent lektor	Kohë e pjeshme
	Msc.	Enela	Mankolli	Shkenca kompjuterike	Asistent lektor	Kohë e pjeshme
	Msc.	Olta	Elezi	Gjuhë gjermane	Asistent lektor	Kohë e pjeshme
	Msc.	Aurora	Gjana	Gjuhë gjermane	Asistent lektor	Kohë e pjeshme

Personeli akademik i Fakultetit të Shkencave Humane me kohë të plotë

Departamenti	Prof. Dr.	Assoc. Prof. Dr	Dr.	Master	Gjithsej
Drejtësi	1	0	4	5	10
Shkenca Islame	0	1	2	4	7
Shkenca Komunikimi	0	0	5	5	10
Gjithsej	1	1	11	14	27

Stafi akademik i Fakultetit të Shkencave Humane me kohë të pjesshme

Departamenti	Prof. Dr.	Assoc. Prof. Dr	Dr.	Master	Gjithsej
Drejtësi	1	1	4	7	13
Shkenca Islame	0	0	2	5	7
Shkenca Komunikimi	0	1	3	3	7
Gjithsej	1	2	9	15	27

Stafi akademik i Fakultetit të Shkencave Humane (me kohë të plotë & me kohë të pjesshme)

Departamenti	Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr.	Master	Gjithsej
Drejtësi	2	1	8	12	23
Shkenca Islame	0	1	4	9	14
Shkenca Komunikimi	0	1	8	8	17
Gjithsej	2	3	20	30	54

Personeli akademik i Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit me kohë të plotë

Departamenti	Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr.	Master	Gjithsej
Gjuhë-Letërsi Angleze	0	0	4	4	8
Shkenca Kompjuterike	0	0	3	5	8
Shkencave të Edukimit	0	1	3	3	7
Gjithsej	0	1	10	12	23

Personeli akademik i Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit me kohë të pjesshme

Departamenti	Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr.	Master	Gjithsej
Gjuhë-Letërsi Angleze	0	0	2	0	2
Shkenca Kompjuterike	0	0	3	7	10
Shkencave të Edukimit	0	0	0	4	4
Gjithsej	0	0	5	11	16

Personeli akademik i Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit (me kohë të plotë & me kohë të pjesshme)

Departamenti	Prof. Dr	Assoc. Prof. Dr	Dr.	Master	Gjithsej
Gjuhë-Letërsi Angleze	0	0	6	4	10
Shkenca Kompjuterike	0	0	6	12	18
Shkencave të Edukimit	0	1	3	7	11
Gjithsej	0	1	15	23	39

Stafi akademik 2019-2020

Kolegji Universitar "BEDËR"2019-2020			
Titulli	Full -time	Part - Time	Gjithsej
Prof. Dr	1	1	2
Assoc. Prof. Dr.	2	2	4
Dr.	21	14	35
Master	26	26	52
Gjithsej	50	43	93

Për vitin akademik 2019-2020, në Fakultetin e Shkencave Humane, raporti studentë-pedagogë është 351 studentë - 54 pedagogë (1 pedagog për 6.5 studentë), ndërsa në Fakultetin e Filologjisë dhe Edukimit ky raport është 283 studentë - 39 pedagogë (1 pedagog për 7.3 studentë).

Raporti në fjalë i Kolegjit Universitar "Bedër", për vitin akademik 2019-2020, është 634 studentë – 93 pedagogë (1 pedagog për 6.8 studentë).

PROGRAMET E STUDIMIT QË OFROHEN NGA DEPARTAMENTI I DREJTËSISË

Departamenti i Drejtësisë në Kolegjin Universitar "Bedër" është pjesë përbërës i Fakultetit të Shkencave Humane. Në përputhje me "Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" Departamenti i Drejtësisë, operon si njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene në disiplinën e shkencave juridike, në përputhje me "Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë".

Departamenti ofron programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë në Drejtësi, konkretisht:

“Bachelor: në Drejtësi

“Master i shkencave” në Drejtësi: Profili / E drejtë Ndërkombëtare

“Master i shkencave” në Drejtësi: Profili / E drejtë Penale

Përmes programeve të studimit të ofruara nga Departamenti i Drejtësisë, synohet përgatitja e individëve të kualifikuar në fushën e drejtësisë, që do të mund t'u shërbejnë institucioneve publike, private dhe të biznesit, si në nivel lokal ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Filozofia jonë mbështetet në vlerat universale të së drejtës, etikën profesionale, zhvillimin e aftësive praktike, me qëllim vendosjen në jetë të projekteve që i shërbejnë individëve dhe shoqërisë në tërësi.

Kërkimi shkencor është një element i rëndësishëm në veprimtarinë e Departamentit të Drejtësisë. Departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare të departamentit. Konferencat shkencore dhe publikimet e vazhdueshme të personelit akademik shërbejnë si garanci për zhvillimin e mëtejshëm të kërkimit shkencor.

Realizimi i synimeve të programit të studimit nga ana e përmbajtjes.

Programet e studimit të ofruara nga departamenti (Bachelor dhe Master) synojnë të realizojnë këto objektiva:

T'u ofrojnë studentëve njohuri të përgjithshme të mbështetura në lëndë të formimit bazë të karaktereve historike dhe filozofike si dhe të realizojnë gjatë viteve akademike thellimin e njohurive që përkojnë me profilin e diplomës në drejtësi, duke vendosur objektiva specifike

për përgatitjen e ekspertëve në fushën e drejtësisë, të aftë për të operuar në këtë fushë, në sektorin shtetëror apo atë privat.

1. T'u ofrojnë studentëve njohuritë bazë që do të jenë të nevojshme për ndjekur ciklet e tjera të studimit, dhe njëkohësisht t'u përgjigjen kërkesave me të cilat do të përballen studentët gjatë ushtrimit të profesionit të tyre.
2. T'u japë studentëve mundësinë të përfitojnë kapacitetet analitike dhe konceptet themelore të ligjit, terminologjinë ligjore, teorinë ligjore dhe procedurat e nevojshme për të trajtuar problematikat teorike dhe praktike në fushën e së drejtës.
3. Të integrojnë mësimdhënien, kërkimin dhe shërbimet në mënyrë që të pasurojnë përvojën e të nxënësve, duke përcjellë rrishtet më të fundit në fushën e shkencës dhe praktikës së jurisprudencës
4. T'u ofrojnë studentëve formimin e eksperiencës profesionale nëpërmjet praktikave profesionale dhe lëndëve të posaçme të klinikës ligjore, me anë të mundësive për të marrë pjesë në zgjidhjen e konflikteve gjyqësore.
5. Të mundësojnë zhvillimin e bashkëpunimit me të gjitha institucionet publike dhe private që janë pjesë përbërëse e sistemit të drejtësisë të vendit, rajonale dhe perëndimore.
6. Të përvetësojnë aftësi për t'iu përshtatur tregut të punës në fusha të ndryshme të së drejtës ndërkombëtare publike dhe private.
7. Të jenë konkurrues në nivel vendor, rajonal, evropian e më gjerë nëpërmjet ofrimit të përvojës dhe kualifikimit të personelit akademik të brendshëm dhe të ftuar, organizimit të debateve dhe diskutimeve në çështje të ndryshme të fushës juridike, si dhe vënies në shërbim të shërbimit të studentëve të një literature të pasur juridike e bashkëkohore.

Programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Drejtësisë në Kolegjin Universitar "Bedër" zhvillohen në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.

Programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor" vazhdojnë tre vite akademike, të cilat plotësohen me 180 kredite (ECTS). Këto programe synojnë t'i pajisin studentët me njohuritë bazë mbi metoda dhe parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në një larmi të gjerë profesioneve e specialitetesh.

Programet e studimit të ciklit të dytë për programin "Master i shkencave" zgjasin dy vite akademike dhe plotësohen me 120 kredite (ECTS). Këto programe synojnë thellimin e njohurive teorike dhe praktike të studentëve në fushën e drejtësisë me studime e trajnime të avancuara dhe kërkim shkencor.

Përmbajtja e programeve të studimit të ofruara nga Departamenti i Drejtësisë përmbush më së miri synimet e vetë programit. Si programi i ciklit të parë të studimit "Bachelor" në Drejtësi, ashtu edhe programi i ciklit të dytë "Master i shkencave" në Drejtësi, ofrojnë një larmi lëndësh të detyrueshme dhe fakultative për studentët.

Studentët njihen dhe thellojnë njohuritë e tyre në disiplina të ndryshme të së drejtës publike dhe private, vendase dhe ndërkombëtare, duke shfrytëzuar literaturën vendase dhe atë të huaj. Gjatë periudhës së studimeve zhvillohen praktika të ndryshme profesionale të cilat mundësojnë

vënien në praktikë të njohurive teorike. Praktikrat profesionale zhvillohen në një sërë institucionesh, brenda dhe jashtë vendit. Seminaret dhe takimet që zhvillohen me ekspertë të fushave të ndryshme ofrojnë një mundësi tjetër për avancimin e njohurive në fusha specifike të së drejtës.

Duke parë ndryshimet e ndodhura në fushën e arsimit dhe duke marrë në konsideratë detyrimin që buron nga nenet 35 dhe 124 pika 7 e Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Departamenti i Drejtësisë së Kolegjit Universitar “Bedër” përveç konsolidimit të funksionimit të tij ka përfshirë në vizionin e tij riorganizimin e programit të ciklit të parë të studimit “Bachelor” në Drejtësi që ofron. Ky riorganizim që vjen si detyrim i ligjit të ri për arsimin e lartë dhe reforma në drejtësi, ka si qëllim bazë jo vetëm rinovimin e ofertës formuese në terma dijesh dhe njohurish por edhe përgatitjen e profesionistëve për sistemin shqiptar dhe ndërkombëtar të drejtësisë.

Mbi bazën e këtij reflektimi parashikohet riorganizimi e programit të ciklit të parë të studimit “Bachelor” në Drejtësi në program të integruar të ciklit të dytë 5-vjeçar “Master i shkencave” në Drejtësi me 300 ECTS.

Lidhja dhe rëndësia e programeve të studimit nisur nga vlerësimi i nevojave për aftësi në tregun e punës

Programet e studimit të ofruara nga ana e Departamentit të Drejtësisë janë në përputhje të plotë qoftë me kërkesat aktuale të tregut të punës, ashtu edhe me zhvillimet e pritshme të ekonomisë shqiptare si një ekonomi në zhvillim, e cila synon integrimin në tregun unik europian. Kurrikulat bashkëkohore synojnë të përgatisin:

- jurist\specialist në institucionet e administratës publike (qendrore/vendore).
- jurist\specialist në institucione ndërkombëtare.
- jurist\specialist\konsulent ligjor në sektorin privat.
- asistent avokat\asistent noter.
- asistent kërkimor\mësimor pranë IAL

Programet e ofruara nga Departamenti i Drejtësisë janë të rëndësishme dhe të kërkuara në tregun e punës. Njohuritë e përfituara gjatë periudhës së studimeve, praktikrat në institucione të ndryshme qendrore e vendore, seminarat e zhvilluara me ekspertë të fushës dhe angazhimi në kërkimin shkencor institucional i pajis studentët me aftësitë e kërkuara në tregun e punës.

PROGRAMET E STUDIMIT QË OFROHEN NGA DEPARTAMENTI I SHKENCAVE TË KOMUNIKIMIT

Informacioni mbi synimet e programeve dhe përshtatshërinë me tregun e punës

Departamenti i Shkencave të Komunikimi është pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Humane. Në mbështetje të “Ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” Departamenti funksionon, si njësi bazë duke ofruar programe studimi në fushën e komunikimit, medias dhe marrëdhënieve me publikun.

Departamenti i Shkencave të Komunikimit në Kolegjin Universitar “Bedër”, duke u bazuar në misionin dhe vizionin që institucioni ka përcaktuar, realizon veprimtarinë e e tij akademike duke ofruar programet e studimit “Bachelor” në Shkenca Komunikimi, në Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu, “Master i shkencave” në Shkenca Komunikimi, me profilet Marrëdhënie Publike dhe Gazetari dhe “Master profesional” në Komunikimi Marketingu.

Misioni i departamentit është përgatitja e individëve të kualifikuar në fushën e gazetarisë, e komunikimit, e marrëdhënieve publike dhe në fusha të ngjashme me to, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale, si edhe mbështetjen e kërkimit shkencor, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe të mbarë shoqërisë, në përputhje edhe me zhvillimet e teknologjisë bashkëkohore, në fushën e medieve të reja.

Ky mision i departamentit është në përputhje të plotë me misionin e institucionit ku bën pjesë. Në zbatim të misionit të departamentit dhe misionit institucional, programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë, në Departamentin e Shkencave të Komunikimit, janë konceptuar në mënyrë që ti ofrojnë studentëve përgatitje akademike cilësorë, nëpërmjet një gërshetimi të mirë organizuar të anës teorike me praktikën në fushën e komunikimit, medias dhe marrëdhënieve publike. Nëpërmjet programeve dhe kërkimit shkencor përgatiten profesionistë të aftë për tregun e punës në kushtet e një shoqërie globale dhe zhvillimi të shpejtë të teknologjive moderne që kanë përfshirë fushën e komunikimit dhe të medias.

Realizimi i synimeve të programit “Bachelor” në Shkenca Komunikimi, “Bachelor” në Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu, programeve të ciklit të dytë “Master i shkencave” në Shkenca Komunikimi, me profilet Marrëdhënie Publike dhe Gazetari dhe “Master profesional” në Komunikimi Marketingu është bërë i mundur nëpërmjet koordinimit të veprimtarive kurrikulare dhe atyre ekstrakurrikulare.

Në programin “Bachelor” në Shkenca Komunikimi objektivat parashikonin përgatitjen e kuadrove të aftë dhe të pajisur me njohuritë bashkëkohore në fushën e gazetarisë dhe komunikimit, përvetësimin e aftësive analitike në marrjen dhe raportimin e informacionit, njohja dhe respektimi i parimeve etike në raportimin e lajmit, etj. Në kuadër të realizimit të këtyre synimeve i është kushtuar një rëndësi e veçantë integritetit të studentëve më tregun mediatik duke i përfshirë në programe intensive praktikash profesionale dhe trajnimesh.

Studentët kanë kryer praktika profesionale pranë medieve kryesore në vend, përfshi këtu mediet vizive, shtypin e shkruar, mediet online, zyrat e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun, në sektorin publik dhe privat. Praktikrat e vitit të kaluar akademik janë realizuar sipas tabelës në vijim;

Praktikat profesionale të studentëve

Nr.	Emër Mbiemër	Viti i studimit	Institucioni	Periudha
1	Lushe Përgjegji	III	ABC Neës	Gusht 2020
2	Erald Kasa	III	Bulqiza.info	Gusht 2020
3	Melsena Danglli	III	Bussines Mag	Gusht 2020
4	Ermal Vaka	III	Albuk TV	Gusht 2020
5	Amantia Kullolli	II	Agjencia Vatra	Gusht 2020
6	Gisela Troplini	I	Albuk TV	Shtator 2020
7	Marina Kërceli	II	Portalishkollor.al	Shtator 2020
8	Besmira Koro	II	Portalishkollor.al	Korrik 2020
9	Krisildi Maxhari	II	Panorama Sport	Korrik 2020
10	Xhesika Poleshi	II	Albuk TV	Korrik 2020
11	Esmeralda Pashollari	II	Hashtag.al	Korrik 2020
12	Megi Iskurti	I	A2 neës	Shtator 2020
13	Melsia Bramka	I	Gazeta Mapo	Shtator 2020
14	Era Tafa	I	Grid Carles	Korrik 2020
15	Hurije Himallari	II	Albsig	Janar 2020
16	Sabina Kurtaj	II	Albsig	Janar 2020
17	Samanta Hysa	II	Albsig	Janar 2020
18	Xhesjon Zogu	II	Bulqiza.info	Korrik 2020
19	Mariglen Kuqa	II	Bulqiza.info	Korrik 2020

Të diplomuarit nga programi i ciklit të parë dhe ciklit të dytë janë përshtatur me kushtet e tregut të punës. Të diplomuarit nga të dy programet, falë planifikimit të departamentit dhe studimit të tregut të punës, kanë arritur të integrohen në një shkallë shumë të lartë.

Statistikat tregojnë se niveli i punësimit në për studentët që janë diplomuar nga programi i ciklit të parë Bachelor në Shkenca Komunikimi është 86%. Ndërsa për studentët e diplomuar nga programi i ciklit të dytë Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi, me profilet Marrëdhënie Publike dhe Gazetari, përqindja e punësimit është 95%.

Rezultatet e studimit të tregut të realizuar në periudhën shtator-tetor 2015, nga një grup pune i ngritur nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit; treguan se sektori i medias po

zhvillohet gjithnjë e më shumë duke u orientuar nga zhvillimet teknologjike dhe format e reja të komunikimit.

Ka një prirje të medieve për të ecur me hapat e vendeve të zhvilluar për të përshtatur metodat e emetimit dhe përcjelljes së programacioneve përmes kanaleve të reja të komunikimit në Internet. Në këtë kuadër, ka patur një zhvillim të madh të gazetarisë online, e cila shfaqet si një alternativë e re përkrah gazetarisë konvencionale. Në lidhje me fushën e marrëdhënieve publike dhe marketingut, vihet re se ajo është një fushë e re në tregun shqiptar, pak o ofruar nga universitetet vendase. Specialistët e punësuar në zyrat e marrëdhënieve publike dhe marketingut etj., në pjesën dërmuese të tyre vijnë nga programet e studimit në fushën e gazetarisë. Përfundimet e nxjerra nga studimi i tregut, por edhe situata e punësimit të studentëve të diplomuar nga programet që ofron departamenti tregojnë lidhjen e rëndësishme të programeve të studimit me nevojat e tregut të punës.

PROGRAMET E STUDIMIT QË OFROHEN NGA DEPARTAMENTI I SHKENCAVE ISLAME

Departamenti i Shkencave Islame është pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Humane në Kolegjin Universitar "Bedër". Në përputhje me ligjin "Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", Departamenti i Shkencave Islame operon si njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene në disiplinën e shkencave islame.

Ky departament përfshin një program "Bachelor" dhe dy programe studimi "Master i shkencave", "Master i shkencave" në Shkenca Themelore Islame dhe "Master i shkencave" në Shkenca Moderne Islame.

Programi i studimeve "Bachelor" në Shkencat Islame parashtron një arsim për të gjithë ata studentë, që janë të interesuar të ndërtojnë karrierën e tyre profesionale si në sektorin publik, ashtu dhe në atë privat në fushën e Shkencave Islame. Ky cikël zgjat tre vite dhe programi është projektuar të ofrojë një horizont intelektual studentëve, duke parashtruar një shumëllojshmëri konceptuale dhe perspektivash në fushën e Shkencave Islame.

Misioni i departamentit të shkencave islame

Misioni i departamentit është formimi i një individi të cilët zotërojnë cilësitë e burimeve Themelore të Shkencave Islame dhe që i lexojnë e i interpretojnë saktë ato, të cilët ndjekin nevojat dhe përparimin e fushës së afërmi, të cilët janë aktivë dhe të gatshëm për të bashkëpunuar (bashkëveprues), janë të integruar në shoqëri, posedojnë vlerat universale dhe që përfaqësojnë profesionin e tyre në mënyrën më të përshtatshme me kulturën dhe traditën shqiptare dhe atë europiane në përputhje me zhvillimet e shekullit XXI.

Vizioni

Ndërsa vizioni i departamentit, i cili përshtatet edhe me vizionin e universitetit, është: të ndihmohen studentët në fitimin e aftësive dhe kompetencave të leximit dhe vlerësimit e burimeve Themelore të Shkencave Islame; edukimi i studentëve në një mënyrë, që ata të thithin

njohuri të mjaftueshme në lidhje me aspektet Sociale dhe Fetare dhe ndërlidhja e tyre me fushën e studimit; aftësitë për t'u shprehur në oratori dhe të shkruar atë që ai ose ajo ka mësuar; zgjidhje për problemet e hasura në fushën e kërkimit dhe propozimi i tyre në institucionet përkatëse; kryerja e praktikave profesionale; risi në mënyrën e aftësimin dhe të përgatitjes së studentëve nëpërmjet një gërshetimi të mirorganizuar të anës teorike me historinë, kulturën, realitetin dhe kushtet bashkëkohore të Shqipërisë, popullit tonë dhe atij botëror.

Objektivat e Departamentit të Shkencave Islame

Për të gjithë ata studentë që synojnë të ndërtojnë karrierën e tyre profesionale dhe akademike në fushë e Shkencave Islame, ky departament ofron:

Përgatitjen e kuadrove të kualifikuar në fushën e Shkencave Islame, të cilët mund të shërbejnë si staf në institucionet e ndryshme në varësi të KMSH-së, në trevat shqiptare, institucionet islame në Shqipëri, si dhe ato në diasporë e më gjerë.

Diplomimin në “Bachelor” dhe “Master i shkencave” në Shkenca Islame e më pas mundësinë e studimeve pasuniversitare edhe në fusha të tjera të shkencave sociale, si: histori, psikologji, sociologji, filozofi, etj., brenda dhe jashtë vendi, e cila i ndihmon të diplomuarit, që të kenë mundësi punësimi jo vetëm brenda instancave të KMSH-së, por edhe në institucione të tjera publike dhe private në Shqipëri dhe në botë.

Ofrimin e mundësive të praktikave profesionale, programeve intership, hapësira të organizimit nga vetë studentët të aktiviteteve ekstrakurrikulare, konferencave studentore dhe mundësi studimi sipas programeve Erasmus.

Kurrikula bashkëkohore në Shkenca Islame.

Zhvillimin e mendimit intelektual nëpërmjet leximit dhe analizimit të burimeve themelore dhe klasike në Shkencat Islame.

Njohjen e historikut, qëllimit, rregullave dhe dispozitave fetare në çështje të caktuara të Shkencave Islame.

Pajisen me të gjitha aftësitë e nevojshme për të zhvilluar kërkime shkencore në fusha të ndryshme të Shkencave Islame dhe atyre sociale.

Mundësi studimi në doktoraturë në institucione publike dhe private brenda dhe jashtë vendit.

Pajisjen e studentëve me njohuri, aftësi dhe përvojë në drejtime të ndryshme të disiplinës së Shkencave Islame të ndërthurura me shkencat sociale, si sociologji, filozofi, psikologji e fesë, pedagogji, etj.

Mundësi për të qenë pjesë e studimeve të thelluara, apo për të kryer praktikat profesionale brenda dhe jashtë vendi.

Mësimdhënie cilësore dhe staf pedagogjik nga disa shtete të huaja.

Formësimin e specialistëve të marrëdhënies ndërkulturore dhe ndërfaqetare në institucione dhe organizata qeveritare dhe OJF-ve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.

Synimet kryesore të programit janë:

1. Të përgatisë të diplomuar të suksesshëm, me aftësi të thella profesionale, cilësi të larta morale dhe shoqërore për t'u kthyer në modele frymëzues dhe motivues për shoqërinë;
2. Të përgatisë njerëz të aftë për të punuar në ambiente publike dhe private;
3. Të përgatisë profesionistë të motivuar për të punuar në të gjitha zonat e vendit dhe më gjerë;
4. Të zhvillojë aftësitë e të menduarit kritik, të komunikuarit saktë dhe me kuptim të qartë të dimensioneve etike në profesion;
5. Të përgatisë ekspertë të kërkuar nga tregu i punës;
6. Të mundësojë një kualifikim shkencor të profesionistëve të rinj me njohuritë e thelluara të shkencave islame në tërësi;
7. Të krijojë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë; aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve.

Këto synime pasqyrohen në objektivat e përgjithshme që ka ky program studimi, si:

T'u japë të diplomuarëve arsimimin e duhur dhe trajnimin e thelluar në fushën e shkencave islame;

Të përpiqet për të realizuar një status të ri të teologut në kushtet dhe zhvillimet e reja ekonomiko-politiko-shoqërore që janë krijuar në ditët e sotme;

Programi do të shtrojë alternativa konkrete për zhvillimin e fesë në Shqipëri dhe të japë ndihmesën e vet për krijimin e një elite të re të teologëve të fesë islame.

Mundësitë e praktikave profesionale:

Studentët e Shkencave Islame kanë mundësi të zhvillojnë praktikat e tyre profesionale në të gjitha institucionet e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, pranë drejtorive të saj në Selinë Qendrore, filialet e saj në rrethe, siç janë myftinitë, shkollat, kurset dhe medresetë ku zhvillohen lëndë të Shkencave Islame, revistat, mediat dhe radio "Spektrum", themeluar nga KMSH, Kolegjin Universitar "Bedër", si dhe praktika jashtë vendit, në institucionet islame shqiptare në diasporë.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Studentët që do diplomohen në Departamentin e Shkencave Islame do të kenë mundësi punësimi në institucione të ndryshme, si specialistë të një fushe, së cilës çdo ditë e më tepër i rritet rëndësia për nga veçantia që përmban, duke përgatitur kadro të një fushe sa specifike, aq dhe të integruar me fusha të ndryshme studimi.

Studentët që do diplomohen nga Departamenti i Shkencave Islame do të kenë mundësi punësimi së pari në të gjitha institucionet në varësi të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë (KMSH), nga Selia Qendrore, deri në zyrat lokale në të gjitha qytetet e Shqipërisë, të drejtuar nga myftinitë, ku edhe të gjitha xhamitë, kurset dhe qendrat kulturore administrohen nga myftinitë e rrethit përkatës.

Së dyti, studentët që diplomohen nga Departamenti i Shkencave Islame mund të punësohen arsimtarë, duke filluar nga ciklet 9-vjeçare e të mesme në medresetë e KMSH-së, që shtrihen në Tiranë, Durrës, Shkodër, Kavajë, Elbasan dhe Korçë. Një tjetër mundësi punësimi është edhe si asistent kërkimor, ose lektor në Kolegjin Universitar “Bedër”.

Në Departamentin e Shkencave Islame deri tani kanë mbaruar dhe vazhdojnë studimet 178 studentë nga 15 shtete të ndryshme të botës.

Vendet ku studentët tanë janë punësuar kryesisht janë Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Kolegji Universitar “Bedër”, medresetë e Shqipërisë, shkolla të tjera në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe vende të ndryshme të origjinës së studentëve nga shtetet prej ku kanë ardhur, etj.

Studentët që diplomohen në Departamentin e Shkencave Islame pranë “Bedër” kanë mundësi të shumta punësimi edhe në institucione të ndryshme arsimore, publike dhe private, si dhe në fondacione dhe shoqata të ndryshme, etj.

Aktualisht mbi 85 % e të diplomuarëve, angazhohen me punë në institucionet e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, pranë drejtorive të saj në Selinë Qendrore, filialet e saj në rrethe, medrese, kurse dhe qendrat kulturore, revistat, mediat dhe Radion e KMSH-së, Kolegjin Universitar “Bedër”.

PROGRAMET E STUDIMIT QË OFROHEN NGA DEPARTAMENTI I GJUHES DHE LETERSISE ANGLEZE

Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, është pjesë përbërëse e Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit. Departamenti në bazë të “Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe kritereve të Kartës së Bolonjës ofron programin e studimit të ciklit të parë: “Bachelor” në Gjuhë dhe Letërsi Angleze. Gjithashtu, departamenti ofron programet e ciklit të dytë: “Master profesional” në Mësuesi: Gjuhë Angleze për Arsimin e Mesëm dhe “Master i shkencave” në Gjuhë dhe Letërsi Angleze.

Qëllimi i departamentit është përgatitja e profesionistëve të aftë për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar nëpërmjet gërshetimit të mirëorganizuar të anës teorike me atë praktike.

Ky departament përbëhet nga një staf akademik me pedagogë shqiptarë dhe lektorë që vijnë nga vende të ndryshme të botës.

Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies:

të ndihmojnë studentët të kuptojnë formimin intelektual dhe kulturor të kombit dhe letërsisë angleze dhe botërore, dhe t'i pajisë ata me konceptet dhe terminologjinë e përdorur në analizën e teksteve letrare.

të ndihmojnë studentët të kuptojnë ndërlidhjen e njohurive rreth aftësive kritike, qasjeve analitike, vizioneve ndërdisiplinore dhe aftësive interpretuese që lidhen me letërsinë.

të nxjerrë studiues të letërsisë për komunikim efektiv, në ligjërime të shkruara dhe të folura, në studime ndërdisiplinore, dhe të ndihmojë studentët të rrisin shkallën e krijueshmërisë, vetëbesimin e tyre dhe të shpalosin ide origjinale në një fushë të caktuar të studimit.

të përgatisë studentët të përfitojnë nga burime të ndryshme të informacionit për të ruajtur zhvillimin e tyre profesional dhe personal në kontekstin e të nxënimit afatgjatë.

të pajisë studentët me rrethana të volitshme bashkëkohore në mënyrë që të shfrytëzojnë të dhënat e hulumtimit tërësisht dhe me efikasitet me ndihmën e teknologjisë më të fundit.

të rrisë ndërgjegjësimin e studentëve mbi parimet ligjore dhe profesionale dhe etikën sociale, si dhe të përdorin njohuritë dhe kapacitetet e tyre si për të mirën e individit ashtu dhe të shoqërisë.

Misioni

Misioni i Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Angleze është përgatitja e individëve me njohuri të thella në fushën e gjuhës dhe letërsisë angleze, zhvillimi i të menduarit kritik dhe aftësive të komunikimit në këtë gjuhë për të kuptuar dhe zbërthyer botën ku jetojmë. Ne synojmë të përgatisim profesionistë frytdhënës me interes për dijen dhe kërkimin shkencor, që do të mund të përballojnë me sukses sfidat e shekullit të 21-të në shërbim të shoqërisë dhe vlerave universale.

Vizioni

Në përputhje me vizionin e institucionit, ne përpiqemi që të bëhemi një institucion i njohur në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e kërkimeve akademike në shërbim të njerëzimit dhe vlerave të tij. Vizioni ynë përfshin gjithashtu edhe përgatitjen e profesionistëve me cilësi e të aftë për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar.

Mundësitë e punësimit

Pas përfundimit me sukses të këtij programi studimor, studentët do të kenë mundësi të ndjekin një shumëllojshmëri karrierash. Mundësitë e punësimit përfshijnë përkthyes në organizata të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare, ambasada ose konsullata, punësim në turizëm, marrëdhëniet me jashtë, banka, shtypin e shkruar dhe shtëpi botuese. Të diplomuarit mund të vazhdojnë studimet si përkthyes dhe interpretues të gjuhës dhe letërsisë angleze. Studentët që përmbushin kërkesat për kualifikim në master profesional mund të punësohen si mësues të

gjuhës angleze në shkolla private ose publike ose në kurse të gjuhëve të huaja për të rinj dhe të rritur.

Programet e studimit

“Bachelor” në Gjuhë dhe Letërsi Angleze

Ky program zgjat tre vite akademike dhe përmban 180 ECTS. Programi është i ndarë në gjashtë (6) semestra. Ai përbëhet nga katër pjesë kryesore. E para është kompetenca në gjuhën Angleze me lëndë si afësi gjuhësore akademike, aftësi komunikimi, etj., të cilat synojnë në pajisjen e studentëve me aftësi të avancuara të shkruari dhe të foluri në anglisht. E dyta është gjuhësia me lëndë si gjuhësi e përgjithshme, morfologji, sintaksë, leksikologji si dhe sociolinguistikë. Pjesa e tretë është letërsia me lëndë që përshkruajnë periudhat dhe autorët më të rëndësishëm në Letërsinë Angleze dhe atë Amerikane si dhe lëndë të veçanta rreth kritikës letrare, poezisë dhe Shekspirit. Pjesa e fundit është komponenti i kulturës dhe civilizimit Britanik dhe Amerikan si përfaqësuesit e botës Anglishtfolëse, por jo vetëm ato. Në program janë përfshirë dhe lëndë mbi literatura të shkruara në Anglisht dhe varietete të kësaj gjuhe.

Ky program ka si objektiv kryesor ofrimin e një arsimit të lartë cilësor për specialistët e ardhshëm të gjuhës dhe letërsisë angleze, mësuesit, studiuesit dhe përkthyesit në një mjedis frymëzues, sfidues dhe frytdhënës. Rëndësi i jepet zhvillimit të kompetencave gjuhësore, njohurive në lidhje me lëndën, aftësi për të përdorur njohuritë në kontekste të ndryshme dhe përvetësimi i vlerave themelore për t'u bërë një anëtar aktiv dhe i përgjegjshëm në komunitet.

Objektivat janë:

Zotërim i njohurive themelore dhe aftësive në zgjidhjen e problemeve për të hyrë në një karrierë profesionale dhe/ose shkollë pasuniversitare.

Zotërim në nivel të avancuar të gjuhës angleze dhe kulturës që ajo përfaqëson.

Njohuri të gjera në të folur dhe të shkruar, të nevojshme për një karrierë të suksesshme profesionale, si dhe me aftësi për të lehtësuar komunikimin ndërkulturor.

Aftësi për punë efektive në grup

Përgatitje e të diplomuarve të aftë të merren me çështjet profesionale dhe etike duke konsideruar efektin e tyre në shoqëri.

Përgatitje e të diplomuarve të aftë për rolet drejtuese profesionale dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.

“Master i shkencave” në Gjuhë dhe Letërsi Angleze:

Programi i studimit “Master i shkencave” në Gjuhë dhe Letërsi Angleze përbëhet nga 120 ECTS dhe zhvillohet në dy vite akademike të ndara në katër (4) semestra. Programi është projektuar t'u ofrojë studentëve një formim intelektual, duke përfshirë të gjitha llojet e

aspekteve praktike dhe teorike të fushës së studimit për të përgatitur ekspertë në filologji, linguistikë dhe letërsinë angleze.

“Master i shkencave” në Gjuhë dhe Letërsi Angleze, si program, është një fushë e cila analizon gjuhën dhe letërsinë angleze. Ai studion zhvillimin historik të gjuhës angleze, marrëdhëniet midis gjuhës dhe të menduarit, si dhe marrëdhëniet midis gjuhës dhe kulturës. Programi përbëhet prej lëndëve të lidhura me gjuhën moderne angleze, letërsinë moderne angleze, gjuhën e vjetër angleze dhe letërsinë folklorike. Gjuha dhe letërsia angleze është një fushë ndërdisiplinore e shkencës që studion gjuhën, literaturën, gjuhësinë, folklorin, historinë, sociologjinë, dokumentacionin dhe arsimin.

Ky program synon të përfshijë të gjitha llojet e aspekteve praktike dhe teorike të fushës së studimit dhe synon të pajisë studentët me një sfond teorik për t'u bërë ekspertë në filologji dhe linguistikë për të analizuar gjuhën Angleze në mënyrë sinkronike dhe diakronike.

Duke paraqitur para studentëve programe të kompletuara me të gjitha njohuritë e nevojshme për një përgatitje sa më të plotë profesionale në gjuhën dhe letërsinë angleze, programi qëndron fort në misionin e tij për të edukuar, për të zgjeruar njohuritë rreth fushës, për të përgatitur studentët për njohjen e thellë dhe analizën e veprave letrare të shkruara në këtë gjuhë duke i shoqëruar ato me analizën e kulturës dhe gjuhës në të cilën ato janë shkruar.

Mundësitë e Punësimit:

Të diplomuarit e programit “Master i shkencave” në Gjuhë dhe Letërsi Angleze mund të kryejnë detyrat e mëposhtme:

- Përkthyes në administratën publike dhe/ose organizata vendase dhe/ose ndërkombëtare
- Pedagogë në universitet
- Ndërmjetësues komunikimi në kompani publike e private që ushtrojnë veprimtari ekonomike e tregtare me palë anglishtfolëse
- Përkthyes dhe/ose redaktues në media
- Komunikues ndërkulturor në fushën e turizmit
- Specialist i marrëdhënieve ndërkulturore në organizata qeveritare dhe/ose OJF të ndryshme
- Mediator i marrëdhënieve midis vendit tonë dhe vendeve të huaja në institucione publike dhe/ose private

“Master profesional” në Mësuesi, Gjuhë Angleze për Arsimin e Mesëm:

Ky program studimi zgjat 1.5 vite akademike (91 ECTS) të ndara në tre (3) semestra. Ai ka për qëllim përgatitjen me cilësi të lartë të mësuesve të gjuhës angleze. Studentët ndjekin kurse në lidhje me pedagogjinë, zhvillimin njerëzor, metodologjinë angleze si dhe një praktikë mësimore në fund të tij. Studentët gjithashtu do të njihen me mjetet për të vlerësuar kërkimet mbi praktikën në klasë. Programi është i hapur për të gjithë kandidatët me një diplomë Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze, përkthim dhe interpretim në anglisht, studime britanike dhe studime amerikane. Mundësitë e karrierës përfshijnë: mësimdhënie në ciklin fillor dhe të

mesëm në institucione të ndryshme publike dhe private, duke i mësuar nxënësit e rinj ose të rriturit nëpërmjet programeve dhe kurseve të ndryshme të gjuhës.

Programin mësimor kryesisht e përbën mësimdhënia dhe mësimet e formacionit pedagogjik. Përveç kësaj mësimi i Gjuhës Angleze, leximi i Letërsisë Angleze si dhe mësimi i metodave të përgatitjes së tezës. Në program është i përfshirë edhe stazhi 1-vjeçar.

Mundësitë e punësimit

Studenti mund të punojë si mësues i gjuhës angleze në institucionet e arsimit të mesëm publik dhe privat

Studenti mund të punojë si instruktor i gjuhës angleze me studentët e rritur në kurse dhe qendra të ndryshme të gjuhës angleze

Studenti mund të punojë si trajnues për mësuesit e gjuhës angleze

Mund të punojë si specialist i programeve specifike të mësimdhënies së gjuhës angleze: ESP: Gjuhë Angleze për Qëllime Specifike dhe ESL: Gjuhë Angleze për Aftësi Specifike Gjuhësore

Si ndërmjetësues komunikimi në kompani publike e private që ushtrojnë veprimtari ekonomike e tregtare me palë anglishtfolëse

Si komunikues ndërkulturor në fushën e turizmit dhe medias

Specialist i marrëdhënieve ndërkulturore në organizata qeveritare dhe/ose OJF të ndryshme.

PROGRAMET E STUDIMIT QË OFROHEN NGA DEPARTAMENTI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT

Departamenti i Shkencave të Edukimit është pjesë përbërëse e Fakultetit të Filologjisë dhe Shkencave të Edukimit. Në përputhje me ligjin "Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", Departamenti i Shkencave të Edukimit operon si njësi bazë mësimore–kërkimore që përfshin fusha kërkimi homogjene në disiplinën e shkencave të edukimit.

Ky departament përfshin dy programe studimi të ciklit të parë “Bachelor”:

në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji

në Arsimin Parashkollor dhe Fillor

si dhe një program të ciklit të dytë të studimeve: “Master i shkencave” në Psikologji Këshillimi.

Mësimdhënia në të gjitha programet e studimit aktualisht zhvillohet në gjuhën angleze duke u ofruar mundësi studentëve për zhvillimin e karrierës akademike dhe profesionale, pas diplomimit dhe duke krijuar fleksibilitet dhe hapësira për transferimin e studimeve të tyre në programe paralele apo të ngjashme të universiteteve perëndimore e më gjerë.

Programi “Bachelor” në Arsim Parashkollor dhe Fillor mundëson arsim dhe edukim për të gjithë ata studentë që janë të interesuar të ndërtojnë karrierën e tyre profesionale në mësuesi ,në ciklin parashkollor dhe fillor, si dhe ndihen të motivuar të thellojnë më tej karrierën e tyre si kërkues dhe kontribues shkencorë në fushën e pedagogjisë. Misioni i programit është të sigurojë arsimim me cilësi të lartë, për të përgatitur studentë të cilët kontribuojnë në mënyrë konstruktive për çështjet arsimore, kulturore dhe sociale në një kontekst lokal dhe europian

Programi “Bachelor” në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji dhe më tej programi “Master i shkencave” në Psikologji Këshillimi është projektuar t’u ofrojë studentëve një formim intelektual dhe profesional të aplikuar në fushën e psikologjisë së këshillimit dhe të pedagogjisë. I veçantë në llojin e tij në mesin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri, programi i pajis studentët me njohuri teorike dhe kritike në fushën e shkencave psikologjike, sociologjike dhe pedagogjike dhe i përgatit ata të aplikojnë parimet e psikologjisë klinike dhe të këshillimit për të diagnostikuar dhe trajtuar problemet me sjelljen e individëve dhe për të qenë kontributorë të denjë në shërbimin psikologjik në shkolla. Pjesë dhe vlerë e shtuar e misionit të programit të Psikologjisë së Këshillimit dhe Pedagogjië (Bachelor dhe Master), krahas edukimit të individëve të kualifikuar dhe të profesionistëve të ardhshëm në fushën e psikologjisë së këshillimit dhe të pedagogjisë, është edhe mbështetja dhe promovimi i përsosmërisë në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe shërbim ndaj komunitetit nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale.

Programet e Departamentit të Shkencave të Edukimit sjellin një risi në mënyrën e aftësimit dhe të përgatitjes së studentëve me anë të gërshtimit në kurrikul dhe në metodologji të mendimit teorik dhe kritik me praktikën në institucione të ndryshme në vendin tonë dhe jashtë trojeve të Shqipërisë.

Me kontributin e tyre në fushën e Shkencave të Edukimit, programet e Departamentit të Shkencave të Edukimit synojnë arritjen e niveleve më të larta të dijes akademike, kompetencave dhe njohurive të aplikuara për studentët duke mundësuar që ata të përshtaten me kërkesat e tregut të punës, të ndjehen të përmbushur nga ana personale dhe profesionale, dhe të formësohen si qytetarë të denjë të një shoqërie globale dhe dinamike.

PROGRAMET E STUDIMIT QË OFROHEN NGA DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

Departamenti i Shkencave Kompjuterike është pjesë përbërëse e Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit. Departamenti në bazë të “Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe kritereve të Kartës së Bolonjës, ofron aktualisht dy programe studimi të ciklit të parë: Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” dhe Bachelor në “Shkenca Kompjuterike”. Departamenti u hap për herë të parë në KU Bedër në vitin akademik në vazhdim: 2018-2019, me vendim nr.1, datë 23.02.2018, të Dekanatit të Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit dhe me Urdhër të MARS nr. 34, dt. 18.07.2018.

Qëllimi i departamentit është përgatitja e profesionistëve të aftë për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar nëpërmjet gërshtimit të mirëorganizuar të anës teorike me atë praktike.

Qëllimi dhe objektivat e mësimdhënies:

- T'i pajisë studentët me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme që kërkon tregu i punës në fushën e teknologjisë kompjuterike.
- T'u ofrojë studentëve njohuritë dhe aftësitë e duhura nga fusha e matematikës, fizikës, dhe fushave të tjera që ndihmojnë në fitimin e aftësive teknike dhe kompjuterike.
- Të ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik dhe racional, të domosdoshëm për ide kreative dhe aplikuese në fushën e teknologjisë.
- Duke shfrytëzuar kohë të mjaftueshme në laboratore dhe praktika profesionale, të lidhë studentët me botën reale ku përdoren njohuritë e marra teorike.
- Të përgatisë studentët të përfitojnë nga burime të ndryshme të informacionit për të ruajtur zhvillimin e tyre profesional dhe personal në kontekstin e të nxënies afatgjatë.
- Të rrisë ndërgjegjësimin e studentëve mbi parimet ligjore dhe profesionale dhe etikën sociale, si dhe të përdorin njohuritë dhe kapacitetet e tyre si për të mirën e individit, ashtu dhe të shoqërisë.

Misioni

Misioni i Departamentit të Shkencave Kompjuterike është përgatitja e individëve me njohuri të thella në fushën e teknologjisë së informacionit dhe shkencave kompjuterike, zhvillimi i të menduarit kritik për të kuptuar dhe për t'u përshtatur në botën që zhvillohet me shpejtësi. Ne synojmë të përgatisim profesionistë frytdhënës me interes për zhvillimin teknologjik dhe kërkimin shkencor, që do të mund të përballojnë me sukses sfidat e shekullit të 21 në shërbim të shoqërisë dhe vlerave universale.

Vizioni

Departamenti i Shkencave Kompjuterike synon të kompletohet me programe të tjera të nivelit "Bachelor" dhe "Master". Në këtë mënyrë, në përputhje me vizionin e institucionit, ne përpiqemi që të bëhemi një njësi e njohur në arenën kombëtare në fushën e kërkimeve teknologjike dhe kompjuterike. Vizioni ynë përfshin gjithashtu edhe përgatitjen e profesionistëve me cilësi e të aftë për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar.

Mundësitë e punësimit

Pas përfundimit me sukses të programeve mësimore të ofruara nga departamenti, studentët do të kenë mundësi të ndjekin një shumëllojshmëri karrierash. Mundësitë e punësimit përfshijnë:

- Specialistë të mirëmbajtjes dhe servisit të pajisjeve kompjuterike
- Google Services

- Specialistë të administrimit të rrjetit kompjuterik të një kompanie ose institucioni
- Specialistë në instalimin e rrjetit të telekomunikacionit
- Specialistë në instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve elektronike matëse
- Specialistë në konfigurimin e sistemeve operative në një kompjuter
- Specialistë në gjuhët e programimit si dhe sigurinë kibernetike, etj.

Programet e studimit

a. “Bachelor” në Shkenca Kompjuterike

Ky program zgjat tre vite akademike dhe përmban 180 ECTS. Programi është i ndarë në gjashtë (6) semestra. Programi “Bachelor” në Shkenca Kompjuterike është projektuar t’u ofrojë studentëve një formim intelektual, profesional e të gjithanshëm në fushën e shkencave kompjuterike. Programi u ofron studentëve njohuri teorike dhe praktike të profileve më të rëndësishme dhe më me prespektive të sistemeve Hardware dhe Software që mbështeten nga shkencat kompjuterike.

Programi i studimit “Bachelor” në Shkenca Kompjuterike ka si mision kryesor t’i përgatisë studentët me njohuri bazë teorike dhe aplikative në fushën e shkencave kompjuterike si dhe në disiplina mbështetëse, të formojë specialist me kompetenca praktike në fushat e dizenjimit dhe implementimit të sistemeve informatike që ata të operojnë si specialistë dhe t’u përgjigjen nevojave të teknologjisë së informacionit në sektorin publik ose privat ku janë të angazhuar.

Vizioni i programit “Bachelor” në Shkenca Kompjuterike është realizimi i studimeve cilësore në fushat përkatëse dhe arsimimi me standarte të larta duke synuar të përgatisë ekspertët më të mirë të fushës në Shqipëri si dhe konkurimin e tyre në rajon.

b. “Bachelor” në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi

Ky program zgjat tre vite akademike dhe përmban 180 ECTS. Programi është i ndarë në gjashtë (6) semestra. Programi “Bachelor” në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi është projektuar t’u ofrojë studentëve një formim intelektual, profesional e të gjithanshëm në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Programi u ofron studentëve njohuri teorike dhe praktike të profileve më të rëndësishme dhe më me perspektive të sistemeve Hardware dhe Software, që mbështeten nga teknologjia e informacionit dhe komunikimit.

Programi i studimit “Bachelor” në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ka si mision kryesor t’i përgatisë studentët me njohuri bazë teorike dhe aplikantëve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe në disiplina mbështetëse; të formojë specialistë me kompetenca praktike në fushat e dizenjimit dhe implementimit të sistemeve informatike, që ata të operojnë si specialistë dhe t’u përgjigjen nevojave në sektorin publik ose privat ku janë të angazhuar.

Programi i studimit “Bachelor” në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi ka si mision kryesor t’i përgatisë studentët me njohuri bazë teorike dhe aplikative në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe në disiplina mbështetëse; të formojë specialistë me kompetenca praktike në fushat e dizenjimit dhe implementimit të sistemeve informatike, që ata të operojnë si specialistë dhe t’u përgjigjen nevojave në sektorin publik ose privat, ku janë të angazhuar.

3. NDRYSHIMET NË STATUTIN DHE RREGULLORET E IAL-SË DHE NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

Kolegji Universitar “Bedër” në përputhje me ligjin nr 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në lidhje me arsimin e lartë ka bërë përditësimet përkatëse në statutin e institucionit ashtu dhe në rregulloret e tij. Këto përditësime do bëhen në vazhdim në përputhje të plotë me kuadrin ligjore që pritet të dalin.

Sa i përket sigurimit të brendshëm të cilësisë, institucioni ka ngritur dy struktura të posaçme:

a) Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit

KPGSCIPS është organ kolegjal që kryen funksione në lidhje me garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe programeve të studimit.

b) Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) është organi përgjegjës për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, për monitorimin dhe koordinimin e veprimtarive të ndërmarra në kuadër të vlerësimit akademik dhe administrativ, për përmirësimin e cilësisë nëpërmjet raporteve të vlerësimit, kontrollin periodik dhe ndjekjen së tyre në institucion

Të dyja këto struktura funksionojnë në përputhje me rregulloret e tyre respektive dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore për arsimin e lartë në Shqipëri.

**PARASHIKIMET E NGARKESËS MËSIMORE TË DEPARTAMENTIT TË DREJTËSISË PËR
VITIN AKADEMIK 2020-2021**

FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË								
VIII AKADEMIK 2020-2021								
SEMESTRI I VJESHITËS								
Departamenti i Drejtësisë - Programi i Integruar i Studimit të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave në Drejtësi"								
Kodi i Lëndës	Lënda	G	P	K	ECTS	L	S	Titullari i lëndës
LAW 101	Histori e Institucioneve	A	80	3	5	3	0	Dr. Ilirjana Kaceli
LAW 111	E Drejtë Romake	A	80	2.5	5	2	1	Dr. Irvin Faniko
LAW 113	E Drejtë Publike I	A	80	2.5	5	2	1	Dr. Irvin Faniko
LAW 103	Gjuhe e Huaj Juridike I	D	80	3	5	3	0	Dr. Gentian Skara
LAW 115	E Drejtë Kushtetuese I	A	65	3.5	5	2	1	Prof. Dr. Ferdinand Gjana
PLS 101/2	Hyrje ne Shkencat Politike	A	80	3	5	3	0	Dr. Ferdinand Xhaferaj
Departamenti i Drejtësisë - Programi Bachelor - Semestri I								
Kodi i Lëndës	Lënda	G	P	K	ECTS	L	S	Titullari i lëndës
LAW 101	Filozofi e së Drejtës	A	78	3	5	3	0	Msc. Ermira Shkreta
LAW 103	Histori e Institucioneve	A	82	3	5	3	0	Dr. Ilirjana Kaceli
LAW 111-1	E Drejta Publike	B	77	3	5	3	0	Msc. Ermira Shkreta
LAW 111-2	E Drejta Publike	B	77	3	5	3	0	Msc. Ermira Shkreta
LAW 113	E Drejtë Romake	B	73	3	5	3	0	Msc. Ermira Shkreta
Departamenti i Drejtësisë - Programi Bachelor - Semestri III								
Kodi i Lëndës	Lënda	G	P	K	ECTS	L	S	Titullari i lëndës
LAW 205	Legal English	E	77	3	5	3	0	Dr. Gentian Skara
LAW 221	E drejta e Punës dhe Sigurimeve Shoqërore	B	66	4	6	3	2	Dr. Irvin Faniko
LAW 223	E Drejtë Civile II	B	63	3.5	5	3	1	Msc. Aranit Qinami
LAW 225	E Drejta Familjare	B	68	3	5	3	0	Msc. Ada Güven
LAW 231	E Drejtë Penale, Pjesa e Përgjithshme	B	65	3.5	5	3	1	Msc. Ermira Bushi
Departamenti i Drejtësisë - Programi Bachelor - Semestri V								
Kodi i Lëndës	Lënda	G	P	K	ECTS	L	S	Titullari i lëndës
LAW 325	E Drejtë e Falimentimit	C	48	3	4	3	0	Msc. Saimir Hoxha
LAW 303	Law and Psychology	A	52	3	4	3	0	Msc. Erilda Ajaz
LAW 311	The European Union Law	B	77	3	5	3	0	Msc. Gentian Skara
LAW 321	E Drejta Tregtare	B	72	4	6	3	2	Msc. Fatri Islamaj
LAW 331	Procedurë Penale	B	72	4	6	3	2	Dr. Nertil Bërdufi
LAW 333	Kriminologji/Penologji	B	77	3	5	3	0	Msc. Ermira Bushi

FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË								
VITI AKADEMIK 2020-2021								
SEMESTRI I PRANVERËS								
Departamenti i Drejtësisë - Programi i Integruar - Semestri II								
Kodi i Lëndës	Lënda	G	PP	K	ECTS	L	S	Titullari i lëndës
ECO 102	Hyrje ne Ekonomi	A	80	3	5	3	0	Dr. Ferdinand Xhaferaj
LAW 114	E Drejtë Publike II	A	80	2.5	5	2	1	Dr. Irvin Faniko
LAW 104	Gjuhe e Huaj Juridike II	D	80	3	5	3	0	Dr. Gentian Skara
LAW 116	E Drejtë Kushtetuese II	A	65	3.5	5	3	1	Prof. Dr. Ferdinand Gjana
LAW 108	Filozofi e së Drejtës	A	80	3	5	3	0	Dr. Ilirjana Kaceli
LAW 102	Historia e shtetit dhe së drejtës ne Shqipëri	A	80	3	5	3	0	Dr. Ilirjana Kaceli
LAW 106	E Drejtë Biznesi	C	76	3	5	3	0	Msc. Ermal Mema
Departamenti i Drejtësisë - Programi Bachelor - Semestri IV								
Kodi i Lëndës	Lënda	G	PP	K	ECTS	L	S	Titullari i lëndës
LAW 212-1	Human Rights	A	52	3	4	3	0	Msc. Ermira Shkreta
LAW 214-1	International Public Law	B	77	3	5	3	0	Dr. Gentian Skara
LAW 216-1	E Drejtë Administrative	B	72	4	6	3	2	Msc. Aranit Qinami
LAW 222-1	E Drejta e Detyrimeve	B	72	4	6	3	2	
LAW 232-1	E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme	B	63	3.5	5	3	1	Msc. Ada Güven
LAW 224	E Drejtë Agrare	D	44	3	4	3	0	Msc. Ermira Bushi
Departamenti i Drejtësisë - Programi Bachelor - Semestri VI								
Kodi i Lëndës	Lënda	G	PP	K	ECTS	L	S	Titullari i lëndës
LAW 322	Procedurë Civile	B	66	4	6	3	2	Msc. Suela Ndreca
LAW 324	International Private Law	B	77	3	5	3	0	Msc. Ermira Shkreta
LAW 302-1	Punimi i Diplomës	F	53	1	7	0	2	Dr. Ilirjana Kaceli
LAW 302-2	Punimi i Diplomës	F	53	1	7	0	2	Dr. Gentian Skara
LAW 302-3	Punimi i Diplomës	F	53	1	7	0	2	Msc. Ermira Shkreta
LAW 302-4	Punimi i Diplomës	F	53	1	7	0	2	Msc. Aranit Qinami
LAW 302-5	Punimi i Diplomës	F	53	1	7	0	2	Msc. Ermira Bushi
LAW 320	E Drejta Financiare	B	56	3	4	3	0	Msc. Ermira Bushi
LAW 306	Albanian Law and EU	D	53	3	4	3	0	Dr. Gentian Skara
LAW 338	Kriminalistikë	D	53	3	4	3	0	Msc. Surja Shehi
LAW 332	E Drejta Ndërkombetare Penale	D	58	3	4	3	0	Msc. Ermira Bushi

FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE DREJTËSISË								
VIII AKADEMIK 2020-2021								
SEMESTRI I VJESHTËS								
Departamenti i Drejtësisë -Programi Master i Shkencave- Profili: E Drejtë Penale- Semestri I								
Kodi i Lëndës	Lënda	G	P	K	ECTS	L	S	Titullari i lëndës
LAW 431	E Drejta Penale, Pjesa e Posaçme e Avancuar	B	80	4	6	4	0	Prof. Dr. Altin Shegani
LAW 433	Procedurë Penale e Avancuar me Praktikë Gjyqësore	B	86	4	6	4	0	Dr. Adnan Xholi
LAW 435	Krimi Financiar dhe Kibernetik	B	75	4	6	4	0	Dr. Nertil Bërdufi
LAW 401	Metoda Kërkimore	A	86	4	6	4	0	Dr. Ferdinand Xhaferaj
LAW 415	Organizatat dhe Institucionet Ndërkombëtare	C	76	3.5	6	3	1	Dr. Ferdinand Xhaferaj
Departamenti i Drejtësisë -Programi Master i Shkencave- Profili: E Drejtë Penale- Semestri III								
Kodi i Lëndës	Lënda	G	P	K	ECTS	L	S	Titullari i lëndës
LAW 531	Politikat Penale	B	76	4	6	4	0	Dr. Bojana Hajdini
LAW 533	Kriminalistikë	C	86	4	6	4	0	Dr. Nertil Bërdufi
Grupi studentor i shoqëruar nga Dr. Genti Kruja dhe lektori Hysni Skura kanë vizituar gjithashtu bibliotekën shekullore të Universitetit të Vjenës, si dhe objekte të ndryshme historike në Vjenë.

Gjatë muajit korrik-gusht dhe më pas gusht-shtator po zhvillohet gjithashtu edhe një shkollë tjetër verore dhe trajnim për studentët e Departamentit të Shkencave Islame, në Universitetin el Ez’her, në Kajro të Egjiptit. Vlen të theksohet se këto shkolla zhvillohen për herë të parë jashtë Shqipërisë, duke u bërë shkas për zhvillimin e edukimit në këtë departament në shumë dimensione.

Më poshtë janë listuar studentët e Kolegjit Universitar “Bedër” që kanë kryer studime universitare semestrale në universitete partnere:

Studentët të cilët kanë studiuar në semestrin e katërt në Universitetin “19 Mayıs” të Samsunit janë:

1. Fabjon Kolaveri
2. Hysni Skura
3. Sabit Gashi
4. Shefki Ferati

Studentët të cilat kanë studiuar në semestrin e katërt në Universitetin “M. Kemal Atatürk” të Erzurumit janë:

1. Fatma Aksu
2. Hasije Uka
3. Rükiye Betül Portakalçı.

Studentët të cilët kanë studiuar në semestrin e pestë në Universitetin “Sülejmân Demirel” të Turqisë janë :

Ana Haxhiu

Lorela Sula

Studentët të cilët kanë studiuar në semestrin e pestë në Universitetin “Sakarja” të Turqisë janë:

Muhammed Billa

Hekuran Uzuni

Studentja e cila ka studiuar në semestrin e pestë në Universitetin “Fatih” të Turqisë është:

Fatma Rabia Kara

Studentet të cilët kanë studiuar në semestrin e katërt në Universitetin “Sülejmân Demirel” të Turqisë janë:

Refia Kara

Migena Jani

Studentët të cilët kanë studiuar në semestrin e katërt në Universitetin “Sakarja” të Turqisë janë:

Fatih Bamja

Adnand Merja

Denis Dosja

Studenti i cili ka studiuar në semestrin e katërt në Universitetin “Fatih” të Turqisë është:

Muhsin Kara

Studentët të cilët kanë studiuar në semestrin e katërt në Universitetin “Sülejman Demirel” të Turqisë janë :

Hanife Atcı

Denisa Nasufi

Arjola Zaçi

Studentët të cilët kanë studiuar në semestrin e katërt në Universitetin “Sakarja” të Turqisë janë:

Leonard Çela

Ledjan Matraxhiu

Aorel Senja

Studenti i cili ka studiuar në semestrin e katërt në Universitetin “Fatih” të Turqisë është:

Samet Vata

Studenti i cili ka studiuar në semestrin e pestë në Universitetin “Fatih” të Stambollit të Turqisë është:

Ali Osman Akcan

Studenti i cili ka studiuar në semestrin e tretë në Universitetin “Fatih” të Stambollit, Turqi, është:

Mustafa Simomi

Studenti i cili ka studiuar në semestrin e pestë në Universitetin “Öndokuz Mayıs” në Samsun të Turqisë është:

Marius Tafani

Studentet të cilët kanë studiuar në semestrin e pestë në Universitetin “Sülejman Demirel” të Ispartës të Turqisë janë:

Lumturi Greca

Fjoralda Belegu

Studentet të cilat kanë studiuar në semestrin e katërt në Universitetin “Sülejman Demirel” të Ispartës të Turqisë janë:

1. Marsida Tafa

2. Zamira Merja

6.7 NUMRI I STUDENTËVE KALUES NË VIT DHE ATYRE TË DIPLOMUAR

PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE

PROGRAMET E STUDIMIT QË OFRONIAL	VITI I			VITI II			VITI III			PËRQINDJA E PUNËSIMIT TË
	REGJISTRUAR	KALUAN NË VITIN PASARDHËS	PËRQINDJA E STUDENTËVE KALUES	REGJISTRUAR	KALUAN NË VITIN PASARDHËS	PËRQINDJA E STUDENTËVE KALUES	REGJISTRUAR	U DIPLOMUAN NË DNP	PËRQINDJA E STUDENTËVE QË	
1. BSc në Drejtësi	32	31	97%	29	25	86%	24	17	71%	83%
2. BSc në Shkenca Islame	7	7	100%	17	13	76%	14	11	79%	78%
3. BSc në Shkenca Komunikimi	14	14	100%	22	22	100%	25	14	56%	92%
4. BSc Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu	19	18	95%	20	18	90%	NA	NA	NA	NA
5. BSc në Gjuhë dhe Letërsi Angleze	19	18	95%	25	21	84%	30	20	69%	75%
6. BSc në Arsim Parashkollor dhe Fillor	NA	NA	NA	17	15	88%	12	10	83%	40%
7. BSc në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji	NA	NA	NA	17	15	88%	13	12	85%	25%
8. BSc Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	15	13	87%	20	17	85%	NA	NA	NA	NA
9. BSc në Shkenca Kompjuterike	17	16	94%	NA	NA	NA	NA	NA	NA	NA
Totali	123	117	95%	167	146	87%	118	84	71%	65.5%

PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE

PROGRAMET E STUDIMIT QË OFRON IAL	REGJISTRUAR	KALUAN NË VITIN PËRQINDJA E PËRQINDJA E STUDENTËVE KALUES	REGJISTRUAR	U DIPLOMUAN NË DND	PËRQINDJA E STUDENTËVE	
1. MSc në Drejtësi (profili e Drejtë Penale)	15	14	93.33%	10	7	70%
2. MSc në Drejtësi (profili e Drejtë Ndërkombëtare)	NA	NA	NA	NA	NA	NA
3. MSc në Shkenca Moderne Islame	9	9	100%	NA	NA	NA
4. MSc në Shkenca Themelore Islame	NA	NA	NA	7	3	42.85%
5. MSc në Shkenca Komunikimi (profili Gazetari)	NA	NA	NA	3	3	100%
6. MSc në Shkenca Komunikimi (profili Marrëdhënie me Publikun)	18	17	94.44%	14	8	57.14%
7. MSc në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji	NA	NA	NA	12	9	75%
8. MSc në Gjuhë dhe Letërsi Angleze	10	10	100%	14	9	64.28%
9. Mp në Mësuesi, Gjuhë Angleze për Arsimin e Mesëm	32	32	100%	26	19	73.07%
Totali	84	82	97.55%	86	58	68.90%

7. FINANCIMI DHE MENAXHIMI I BURIMEVE

7.1 PLANI BUXHETOR AFATMESËM DHE PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË INSTITUCIONIT

Plani Buxhetor Afatmesëm 2018-2021			
Te Ardhura & Shpenzime	Viti aktual planifikim 2018-19	Vit II planifikim 2019-20	Viti III planifikim 2020-21
	Totali	Totali	Totali
Te Ardhura			
Te Ardhura nga Sherbimet	€ 590,000	€ 690,000	€ 750,000
Donacione	€ 144,000	€ 100,000	€ 80,000
Te tjera	€ 70,000	€ 50,000	€ 20,000
Te mbartura nga viti paraardhes	€ -	€ 700	€ 4,917
Totali I Te Ardhurave	€ 804,000	€ 840,700	€ 854,917
Shpenzimet e Personelit			
Personel paga	€ 375,700	€ 400,963	€ 451,300
Personel kontribute	€ 157,200	€ 164,390	€ 185,050
Totali I shpenzimeve te personelit	€ 532,900	€ 565,353	€ 636,350
Shpenzimet Operative			
Uje, energji elektrike, gaz	€ 24,240	€ 24,240	€ 30,000
Shpenzime per Blerje te Pastokueshme	€ 5,470	€ 5,500	€ 7,000
Nentrajtime	€ 3,220	€ 3,220	€ 3,220
Shpenzime Qiraje	€ 204,000	€ 204,000	
Shpenzime Mirembajtje	€ 2,400	€ 2,400	€ 7,200
Shpenzime Sigurimi	€ 6,720	€ 6,720	€ 7,500
Sherbime te Tjera	€ 3,000	€ 3,000	€ 4,000
Shpenzime Marketingu	€ 5,500	€ 5,500	€ 10,000
Shpenzime Komunikimi dhe Postare	€ 240	€ 240	€ 480
Shpenzime bankare	€ 521	€ 521	€ 521
Taksa e tarifa vendore	€ 113	€ 113	€ 113
Shpenzime per Dhurata, Pritje e Percjellje	€ 5,676	€ 5,676	€ 5,676
Shpenzime te tjera rrjedhese	€ 2,500	€ 2,500	€ 2,500
Totali i Shpenzimeve Operacionale	€ 263,600	€ 263,630	€ 78,210
Investime	€ 6,800	€ 6,800	€ 106,800
Totali I Shpenzimeve	€ 803,300	€ 835,783	€ 821,360
Teprica ne mjetet monetare / (Mungesa)	€ 700	€ 4,917	€ 33,557

Të ardhurat

Të ardhurat kryesore të Kolegjit Universitar “Bedër” vijnë nga arkëtimet e studentëve. Për vitin akademik 2019-2020 ishin parashikuar € 550 000 të ardhura nga studentët, por vetëm € 432 593 arritën të realizohen.

Edhe të ardhurat e tjera ishin nën vlerën e parashikuar. Padyshim që një ndikim të rëndësishëm në këtë rënie ka pasur gjendja e krijuar prej pandemisë Covid-19.

Bazuar në parashikimet e të ardhurave në total kemi një rënie prej € 176 624. Për vitin akademik 2019-2020 realizuam vetëm 80.8 % të të ardhurave të parashikuara.

Shpenzimet e personelit

Shpenzimet për pagat dhe siguracionet e personelit ishin parashikuar € 550 900, por vetëm € 432 593 u shpenzuan për personelin, pra 78.5 % e shumës së parashikuar.

Shpenzimet operative

Shpenzime operative ishin parashikuar € 276 427, por realisht u shpenzuan € 267 668, 3.4% më pak se shuma e parashikuar.

Shpenzimet në total ishin € 200 099 me pak krahasuar me parashikimet.

Në vitet në vijim, duke pasur synim hapjen e programeve të reja, parashikohet të ketë rritje në numrin e studentëve, gjë e cila sjell edhe rritje të të ardhurave.

Objektivi ynë është të kemi rritje të të ardhurave nga viti në vit, duke ndjekur një strategji dhe menaxhimi sa më të mirë të shpenzimeve tona, në mënyrë që të vijojmë qëndrueshmërinë financiare.

Realizimi faktik i planit buxhetor të vitit parardhës dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik në vijim

Buxheti realizuar per vitin akademik 2019-2020

Te Ardhura & Shpenzime	Planifikim 2019-20	Vti i mbyllur arsimor 2019-20
	Totali	Totali
Te Ardhura		
Te Ardhura nga Sherbimet	€ 550,000	€ 432,593
Donacione	€ 210,000	€ 190,776
Te tjera	€ 130,000	€ 90,007
Te mbartura nga viti paraardhes	€ 28,632	€ 28,632
Totali I Te Ardhurave	€ 918,632	€ 742,008
Shpenzimet e Personelit		
Personel paga	€ 525,000	€ 383,989
Personel kontribute	€ 85,505	€ 63,170
Totali I shpenzimeve te personelit	€ 610,505	€ 447,159
Shpenzimet Operative		
Uje, energji elektrike, gaz	€ 22,240	€ 14,320
Shpenzime per Blerje te Pastokueshme	€ 5,000	€ 0
Nentrajtme	€ 3,220	€ 0
Shpenzime Qiraje	€ 204,000	€ 215,970
Shpenzime Mirembajtje	€ 14,560	€ 10,982
Shpenzime Sigurimi	€ 8,379	€ 6,948
Shpenzime per fotokopje dhe printime		€ 3,504
Shpenzime per materila kancelari		€ 1,916
Shpenzime per materiale elektronike		€ 1,159
Shpenzime konference		€ 1,245
Shpenzime te tjera	€ 2,500	€ 2,876
Sherbime te Tjera	€ 3,000	
Shpenzime Marketingu	€ 5,500	€ 4,771
Shpenzime Interneti, Komunikimi dhe Postare	€ 2,532	€ 2,069
Shpenzime Transporti	€ 0	
Shpenzime bankare	€ 521	€ 466
Taksa e tarifa vendore	€ 113	€ 122
Te tjera Tatime e Taksa	€ 1,186	€ 1,320
Shpenzime per Dhurata, Pritje e Percjellje	€ 3,676	
Totali i Shpenzimeve Operative	€ 276,427	€ 267,668
Investime	€ 30,000	
Humbje nga kembimet valutore		€ 4,006
Totali I Shpenzimeve	€ 916,932	€ 718,833
Teprica ne mjetet monetare / (Mungesa)	€ 1,700	€ 23,175

Tarifat e studimit për vitin akademik 2020-2021 janë, si më poshtë:

NR.	CIKLI STUDIMEVE ^I	EMËRTIMI I PROGRAMIT	TARIFA STUDIMIT 1F ² ^E
1	Bachelor	Drejtësi	€ 2,000
2	Bachelor	Shkenca Komunikimi	€ 2,000
3	Bachelor	Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu	€ 2,000
4	Bachelor	Shkenca Islame	€ 2,000
5	Bachelor	Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	€ 2,200
6	Bachelor	Shkenca Kompjuterike	€ 2,200
7	Bachelor	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	€ 2,000
8	Bachelor	Multimedia dhe Grafik Dizajn	€ 1550
9	Bachelor	Web Development	€ 1750
10	Bachelor	Drejtësi	€ 2,000
11	Bachelor	Shkenca Komunikimi	€ 2,000
12	Master Shkencor	Drejtësi - Profili e Drejtë Penale	€ 2,000
13	Master Shkencor	Drejtësi - Profili e Drejtë Ndërkombëtare	€ 2,000
14	Master Shkencor	Shkenca Komunikimi - Profili Gazetari	€ 2,000
15	Master Shkencor	Shkenca Komunikimi - Profili Marrëdhënie Publike	€ 2,000
16	Master Profesional	Komunikim Marketingu	€ 2,000
17	Master Shkencor	Shkenca Moderne Islame	€ 2,000
18	Master Shkencor	Shkenca Themelore Islame	€ 2,000
19	Master Shkencor	Gjuhë dhe Letërsi Angleze	€ 2,000
20	Master Profesional	Mësuesi - Gjuhë Angleze për Arsimin e Mesëm	€ 2,000

² Tarifat e studimit janë për një vit akademik

7.2 SHLYERJA E DETYRIMEVE TATIMORE SI DHE SIGURIMEVE SHOQËRORE E SHËNDETËSORE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RAJONALE E TATIMEVE TIRANE

Nr. T03186813

Datë, 25.11.2020

VËRTETIM

(Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin - E-SIG 02/a)

Vërtetojmë se për Personin Juridik / Fizik FONDACIONI "HAFIZ ALI KORÇA", me numër NIPT-i L72003451N, me përfaqësues ligjor Z/Znj. Dritan Laçi, në mbështetje të deklarimeve e pagesave për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe të dhënave të rubrikave të formularit "Listëpagesa e kontributeve për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi", të deklaruara nga subjekti, por që akoma ndodhen në Drejtorinë Rajonale Tatimore, rezultojnë keto të dhëna:

Nr	Periudha tatimore	Numri i Kontributeve	Detyrimet(kontributet, interesat) Në lekë	Pagesat(kontributet, interesat) Në lekë
1	2010	69	1,196,310	1,198,994
2	2009	69	511,769	518,030
3	2008	71	512,427	518,694
4	2007	71	526,283	533,927
5	2006	100	773,516	773,516
6	2005	102	699,381	700,984
7	2004	107	868,150	883,413
8	2003	107	1,458,277	1,481,684
9	2002	109	1,461,962	1,461,962
10	2001	109	1,465,589	1,477,912
11	1912	110	1,468,045	1,493,542
12	1911	112	1,496,718	1,503,696
13	1910	96	1,342,682	1,342,682
14	1909	76	1,213,387	1,213,387
15	1908	80	1,258,986	1,279,196
16	1907	79	1,262,772	1,288,833
17	1906	107	1,455,416	1,464,316
18	1905	108	1,516,631	1,545,614
19	1904	109	1,525,031	1,525,031
20	1903	106	1,493,998	1,518,401
21	1902	105	1,394,011	1,394,011
22	1901	105	1,466,795	1,485,053
23	1812	107	1,469,161	1,496,835
24	1811	108	1,472,810	1,472,810
25	1810	101	1,429,695	1,429,695
26	1809	74	1,200,383	1,200,383
27	1808	76	1,224,732	1,264,594



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RAJONALE E TATIMEVE TIRANE

Nr. T03186857

Datë, 25.11.2020

VËRTETIM
(Për pagim Detyrimesh)

Vërtetojmë se:

Z./Znj. Dritan Laçi

Tatimpaguesi: FONDACIONI "HAFIZ ALI KORÇA"

NIPT-i: L72003451N

Aktiviteti: Aktivitetet e shoqatave e organizimeve ekonomike dhe punëdhënësve

Adresa:

RRUGA GEORGE W.BUSH,NR.50, Tirane, Tirana

Rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor te papaguar deri më datën: 25.11.2020 ora 12:12:17

Ky vërtetim jepet për efekt DOKUMENTI.

Drejtuesi i Shërbimit të Tatimpaguesve



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Rajonale Tatimore Tirane
Date: 2020/11/25 12:12:23 +0200
L72003451N20201125121215631004

Shënim : Ky dokument është sjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria
Rajonale Tatimore Tirane)

8. PLOTËSIMI I STANDARDEVE SHETËRORE AKADEMIKE DHE INFRASTRUKTURE

Standardet Akademike

Kolegji Universitar “Bedër”, tashmë si një institucion i mirënjohur dhe me përvojë në fushën akademike dhe në tregun e Arsimit të Lartë, aplikon standarde të larta në zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse dhe kërkimore–shkencore, me qëllim diplomimin e studentëve sa më të kualifikuar dhe konkurrues në tregun e punës. Standartet evidentohen në disa aspekte si:

Numri i përshtatshëm i studentëve në auditore (seminare dhe leksione),

Zhvillimi i orëve në auditor,

Frekuentimi i detyruar i auditorit (leksione, seminare),

Implementimi i nje sistemi vlerësimi nëpërmjet disa mënyrave të të provuarit të dijes dhe kontrolli periodik i dijeve,

Përdorimi i mjeteve audio-vizive si smartboard, me qëllim zhvillim sa më interaktiv të mesimit në auditor,

Ndërdisiplinarizimi i programit mësimor,

Rishikimi periodik i programeve (silabuseve) të lëndëve,

Proporcionalizimi i ngarkesës mësimore,

Aplikimi i projekteve fillestare të kërkimit shkencor tek studentet.

KU “Bedër” ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij

Kolegji Universitar “Bedër” është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.286, dt.06.04.2011 “Për lincensimin e shkollës së lartë private “Hëna e Plotë” (Bedër) Tiranë. Kolegji Universitar e ka filluar veprimtarinë e tij gjatë vitit akademik 2011-2012 në mjediset që ndodhen në adresën: Rruga “Jordan Misja“,Tiranë.

Gjatë nëntë viteve nga krijimi i tij (2011 – 2020) Fakulteti i Shkencave Humane është konsoliduar në programet mësimore (kurrikula), në personelin akademik, metodat e mësimdhënies duke diplomuar deri tani 7 gjenerata studentësh (2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020) në programet e licensure dhe akredituara, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, të cilët janë punësuar në masën rreth 96%.

Kolegji Universitar “Bedër” ka si qëllim:

1. të përgatisë specialistë të lartë me dije të nivelit bashkëkohor në fushën e shkencave islame, jurisprudencës, shkencave të komunikimit, shkencave kompjuterike, shkencave të edukimit, gjuhëve të huaja, duke zhvilluar programe studimi në profilet përkatëse në auditorë etj.;
2. të realizojë veprimtari studimore e kërkime shkencore në fushat dhe sektorët që mbulon, të përcaktuara më lart, vetëm ose në bashkëpunim me institucione homologe, sipërmarrje private, organizata jofitimprurëse vendase dhe ndërkombëtare;
3. të ofrojë kualifikime shkencore pasuniversitare, kurse specializimi, praktika mësimore etj. në shkencat dhe disipinat e mësipërme;
4. të bashkëpunojë me institucione të arsimit të lartë, brenda e jashtë vendit, duke synuar edhe realizimin e programeve të përbashkëta të studimit dhe lëshimin e diplomave të përbashkëta apo/dhe të dyfishta.

KU “Bedër” për vitin akademik 2019-2020 ka qenë i organizuar në 2 fakultete: Fakulteti i Shkencave Humane dhe Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit, të cilët janë të strukturuar në të paktën 3 njësi bazë si departamente, si dhe në njësi ndihmëse siç është qendra kërkimore-shkencore, bibliotekat e të tjera, sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin për arsimin e lartë. Duke filluar nga viti akademik 2020-2021, Kolegji Universitar “Bedër” shfaqet i riorganizuar në njësitë kryesore, të cilat përbëhen nga 2 fakultete: Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë (FSHHD) si dhe Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit (FTB), të cilët janë të strukturuar në të paktën 3 njësi bazë si departamente, qendra kërkimore shkencore si dhe struktura ndihmëse si biblioteka, e të tjera, sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin për arsimin e lartë.

Me ndryshimin e ligjit “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kolegji Universitar “Bedër” ka ristrukturuar programet dhe bazën ligjore të institucionit, me qëllim përshtatjen dhe strukturimin e tyre në përputhje me ligjin dhe kërkesat e Kartës së Bolonjës.

Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës

Kolegji Universitar “Bedër” ofron studime në 9 programe të ciklit të parë dhe 8 të ciklit të dytë.

Zgjedhja e këtyre programeve është bërë nisur nga nevojat e tregut të punës, duke i konsideruar këto programe si tejet të rëndësishme për zhvillimin e shtresave të ndryshme të shoqërisë. Qëllimet tona strategjike përfshijnë forcimin e kritereve tona të pranimit të studentëve, rritjen e cilësisë së arsimit, rritjen e ndikimit të hulumtimit dhe mbështetjes së risive tona. Një institucion me strategji të qëndrueshme është e aftë t’u adresohet problemeve dhe nevojave aktuale, si dhe të posedojë mundësinë e një menaxhimi strategjik dhe fleksibël për të përgatitur të ardhmen e suksesshme të një shoqërie.

Programet e studimit janë përzgjedhur, për të përmbushur nevojat që do të ketë vendi ynë në të ardhmen, duke përgatitur studentë të aftë profesionalisht edhe me integritet për t’i shërbyer vendit tonë, rajonit dhe më gjerë.

Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre

Kolegji Universitar “Bedër” është përgjegjës për sigurimin e cilësisë në përgatitjen e studentëve, sipas standarteve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR). Për verifikimin periodik të cilësisë është krijuar Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila përbahet nga pesë anëtarë, tre pedagogë të brendshëm, një student dhe një ekspert i jashtëm. Kjo njësi varet drejtpërdrejt nga Rektori, ka autonomi operative dhe mundësi në të gjitha të dhënat e institucionit. Njësia kryen vëzhgime dhe studime të vazhdueshme në procesin mësimor dhe shkencor, duke përgatitur raporte me shkrim, të cilat u paraqiten Dekanateve dhe më lart.

Kompetencat e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë:

Të hartojë politikat dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akte të cilat miratohen nga Senati Akademik.

Të hartojë standardet për sigurimin e cilësisë, në përputhje me Kodin e Cilësisë.

Të vlerësojë, në mënyrë periodike, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore në njësitë kryesore të Kolegjit, në përputhje me standardet.

Të kryejë studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Kolegji, në bashkëpunim me njësitë përkatëse.

Në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve, ajo organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi, në bashkëpunim me sekretarinë mësimore.

Pas çdo vlerësimi raporton para Senatit Akademik rezultatet dhe propozimet përkatëse.

Një ndihmesë të rëndësishme në këtë drejtim luan njësia ndihmëse, pjesë e strukturës organizative të IAL: Zyra e kurrikulave, e cila luan rol të rëndësishëm paralel me këshillat e departamenteve dhe dekanatet në rishikimin periodik të programeve, planeve mësimore, si dhe përmirësimin e tyre.

KU “Bedër” ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit

Personeli në Kolegji Universitar “Bedër” përbëhet nga:

- Personeli akademik
- Personeli ndihmës akademik
- Personeli administrativ

Departamentet, si njësi bazë, kanë në përbërje të tyre të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët, të paktën tre janë me gradë shkencore dhe/apo titull akademik. Lidhur me raportin personel pedagog-student, deklarojmë që raporti personel akademik (i brendshëm dhe i jashtëm) - student është mbajtur në masën 6.8 studentë / pedagog, duke mundësuar punën intensive me studentët për të mbështetur dhe monitoruar nga afër rritjen e tyre cilësore dhe profesionale, vit pas viti.

Gjatë vitit akademik 2019-2020 në Kolegjit Universitar “BEDËR” janë angazhuar 93 pedagogë (efektivë dhe joefektivë) për 634 studentë. Raporti është 6.8 studentë / pedagogë, duke mundësuar punën intensive me studentët për të mbështetur dhe monitoruar nga afër rritjen e tyre cilësore dhe profesionale, vit pas viti.

Ky raport tregon rëndësinë që i japim raportit student-pedagog, duke ruajtur kështu jo vetëm raportin, por duke rritur ndjeshëm edhe cilësinë.

Objektivi i Kolegjit Universitar “BEDËR” në këtë drejtim është dhe do të mbetet gjithmonë tërheqja e personelit të kualifikuar, kryesisht me grada dhe tituj shkencorë, standard i përcaktuar në strategjinë e zhvillimit të institucionit. Për të plotësuar nevojat për personel akademik me tituj e grada shkencore kemi zgjedhur të kombinojmë punësimin e profesionistëve vendas dhe të huaj, me eksperiencë në fushën akademike.

Për studimet e ciklit të parë dhe të dytë, raporti personel akademik (i brendshëm + i jashtëm) është në nivele shumë të kënaqshme duke mundësuar punën intensive me studentët, për të mbështetur e monitoruar nga afër rritjen e tyre cilësore e profesionale vit pas viti.

Kolegji Universitar “Bedër” plotëson edhe kriteret që pedagogët e çdo lënde/moduli të ciklit të dytë, të kenë së paku gradën shkencore "Doktor".

Standarde në vlerësimin e studentëve dhe promovimin e dijeve

Kolegji Universitar “Bedër” aplikon rregulla dhe standarde të larta për vlerësimin e studenteve dhe të provuarit të dijës, si :

Provime të ndërmjetme për njohuritë e marra, vlerësime për aktivizimet në leksione, vlerësime për detyra kursi, si edhe provim përfundimtar për lëndën, të cilat specifikohen në programet mësimore për secilën lëndë.

Për sa i përket mënyrës së vlerësimit të dijeve, janë aplikuar vlerësimi me shkrim, vlerësimi me shkrim dhe me gojë dhe vlerësimi me gojë për studentët me aftësi të kufizuara.

Këto mënyra vlerësimi janë aplikuar me qëllim arritjen e një shpërndarje të drejtë të ngarkesës për studentin (jo vlerësim vetëm në fund të semestrit), si edhe për të arritur një studim sistematik të studentit, me qëllim formimin cilësor të tij.

Respektimi i legjislacionit në fuqi

Si institucion që promovon dijet dhe vlerat, Kolegji Universitar “Bedër” edhe në të ardhmen do të jetë në funksion të realizimit të objektivave të tij konform dispozitave ligjore në fuqi.

Standardet Infrastrukturore

Kolegji Universitar “Bedër” ushtron aktivitetin e tij në ambiente: godinë 7-katëshe dhe godinë 2-katëshe, në adresë kompleksi “Usluga”, Rr. “Jordan Misja”, bazuar në kontratën e qirasë dt 1.9.2017. ndërmjet Fondacioni Hafiz Ali Korca dhe Shoqëria Usluga sh.p.k.

Ambientet e Kolegjit universitar kanë një infrastrukturë moderne, të pajisura me kondicionerë, dhe përbëhet nga 14 klasa me kapacitet ulës gjithsej 486 vende, 1 sallë konferencash me kapacitet 180 vende, 1 laborator kompjuteri me kapacitet 24 vende, sallë gjyqesh dhe Neës Room e cila përdoret për aktivitete mësimore. Auditoret janë të pajisura me video-projektorë, me tabela inteligjente, të cilat bëjnë të mundur zhvillimin normal të procesit mësimor. Gjithashtu, përveç mjediseve të mësimi, ka dhe shumë ambiente çlodhëse për studentët, si: mensë, bibliotekë, mjedise për Këshillin Studentor dhe Klubet Studentore etj.

Kolegji universitar shfrytëzon edhe ambientet e shërbimit/teknike, që u shërbejnë funksioneve të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Mjedisi mundëson burime alternative energjie dhe uji, pasi është i pajisur me elektro-pompë, depo uji si dhe gjenerator.

Kolegji Universitar “Bedër” zhvillon aktivitetin e tij larg zonave industriale apo me ndotje përtej normave të lejuara, në ambiente të ndërhuara me materiale cilësore, që plotësojnë kushtet higjeno-sanitare dhe nuk shfaqin rrezikshmëri për studentët apo personelin akademik e administrativ.

Kapacitetet infrastrukturore

Referuar udhëzimit nr.11 datë 28.02.2011, në pikën 4 të shtojcës (nr.3) për standardet (minimale) dhe normativës për infraskturën e institucioneve private të arsimit të lartë shprehimisht citohet që objektet që do të ofrohen për institucionet e arsimit të lartë privat, kryesisht për ambientet si më poshtë:

Auditorë mësimi,

Ambiente për laboratorë,

Ambiente për personelin pedagogjik,

Ambiente për personelin administrativ,

Ambiente për bibliotekën senatin, salla audiovizive, kompjuterësh, multimedia, etj.,

Ambiente teknike.

Institucioni duhet të plotësojë normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme prej 3.8 – 4.0 m²/student (minimumi) dhe 7.5 - 8.0 m²/student (maksimumi). Lartësia e ambienteve duhet të jetë jo më e vogël se 3.0 m (tavan – dysheme).

Në pikën 5 të shtojcës (nr.3) për standardet (minimale) dhe normativës për infraskturën e institucioneve private të arsimit të lartë shprehimisht citohet që nyjet hidrosanitare duhet të parashikohen 1 boks dhe lavaman për 35-40 djem. 1 boks dhe lavaman për 30 vajza si dhe 1 boks dhe lavaman për administratën, mundësisht dhe ujë të ngrohtë.

Në ambientet e mësimi, objekti duhet të plotësojë normativat teknike të ndriçimit natyral, sipërfaqja e dritareve duhet të mbulojë minimalisht (15 – 20) % të sipërfaqes së dyshemese dhe ndriçimi duhet të jetë i orientuar nga krahu i majtë i studentit, mundësisht i orientuar nga

juglindja. Ndriçimi duhet të realizohet nga dritare (rekomandohet me dopio xham) të tejdukshëm.

Objektet e arsimit të lartë privat me më shumë se 200 studentë (në një godinë), detyrimisht duhet të jenë të pajisura me dalje dhe shkallë emergjence.

VLERËSIMI I KAPACITETEVE PRITËSE

Institucioni bazuar në udhëzimet e MAS, duhet të plotësojnë normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme prej 3.8 – 4.0 m² /student (minimumi). Lartësia e ambienteve duhet të jetë jo më e vogël se 3.0 m (tavan – dysheme).

Kolegji Universitar “Bedër” ushtron funksionet e tij në dy godina, të cilat kanë një sipërfaqe gjithsej prej 5628 m². Në këto mjedise rezulton se aktualisht studiojnë 617 studentë. Nga ky numër 356 studentë ndjekin studimet pranë Fakultetit të Shkencave Humane dhe 261 studentë që ndjekin studimet pranë Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit. Shpërndarja e studentëve varion sipas procesit akademik dhe mjediseve, që përdoren njëkohësisht nga të dy Fakultetet.

Sipas numrit të studentëve që aktualisht ndjekin studimet në IAL, institucioni ofron mesatarisht 10 m²/student, (5628m² ÷ 610 studentë = 9.2 m² për student)

Në këtë kontekst mjedisor kapaciteti pritës maksimal në programet e studimit në institucionin tonë është:

$$5628 \text{ m}^2 \div 4.0 \text{ m}^2 / \text{student} = 1407 \text{ studentë}$$

Numri aktual i studentëve të regjistruar në institucion është 610, prej këtyre;

406 në programet e ciklit të parë dhe 204 janë të regjistruar në programet e ciklit të dytë.

Numri i studentëve që priten të diplomohen këtë vit akademik për afërsisht është 219 studentë, prej këtyre;

137 studentë në programet e ciklit të parë dhe 82 në programet e ciklit të dytë.

Aktualisht, duke mos përfshirë në llogaritje studentët që priten të diplomohen, kapacitetet pritëse për pranimet në programet e studimit janë si më poshtë:

1407 studentë (kapaciteti pritës maksimal) – 391 studentë (studentë të regjistruar) = 1010 studentë.

Ndërkohë që nëse përfshijmë në llogaritje studentët që priten të diplomohen, kapacitetet pritëse për pranimet në programet e studimit janë si më poshtë:

1407 studentë (kapaciteti pritës maksimal) – 610 studentë (studentë të regjistruar) = 797 studentë.

Për sa më lart vëmë re që institucioni bazuar në sipërfaqet që ofron, ka kapacitete maksimale pritjeje për 1066 studentë dhe kapacitete minimale pritjeje për 790 studentë.

Lartësia mesatare e ambienteve është 3.27m (tavan - dysheme), sa më sipër, institucioni i përmbush kërkesat e akteve nënligjore.

Tabela 1

<i>Programet e ciklit të parë</i>	<i>Viti I</i>	<i>Viti II</i>	<i>Viti III</i>	<i>Gjithsej</i>
Bachelor në Arsimin Parashkollor dhe Fillor	1	15	11	27
Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze	18	22	34	74
Bachelor në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji	0	15	12	27
Bachelor në Shkenca Kompjuterike	17	0	0	17
Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	14	17	0	31
Bachelor në Drejtësi	32	25	31	88
Bachelor në Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu	19	18	0	37
Bachelor në Shkenca Islame	7	13	13	33
Bachelor në Shkenca Komunikimi	14	22	36	72
Gjithsej	122	147	137	406

Tabela 2

<i>Programet e ciklit të dytë</i>	<i>Viti I</i>	<i>Viti II</i>	<i>Gjithsej</i>
Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze	10	15	25
Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji	0	14	14
Master Profesional në Mësuesi, Gjuhë Angleze për Arsimin e Mesëm	32	27	59

Master i Shkencave në Drejtësi / Profili e Drejta Ndërkombëtare	0	1	1
Master i Shkencave në Drejtësi / Profili e Drejta Penale	14	11	25
Master i Shkencave në Shkencat e Komunikimit / Profili Gazetari	0	5	5
Master Profesional në Komunikim Marketingu	0	0	0
Master i Shkencave në Shkencat e Komunikimit / Profili Marrëdhëniet me Publikun	17	29	46
Master i Shkencave në Shkencat Moderne Islame	9	9	18
Master i Shkencave në Shkencat Themelore Islame	0	11	11
Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze	10	15	25
Gjithsej	82	122	204

Lidhur me kërkesën e pikës 5 të shtojcës (nr.3) për standardet (minimale) dhe normativës për infraskaturën e institucioneve private të arsimit të lartë shprehimisht citohet që nyjet hidrosanitare duhet të parashikohen 1 boks dhe lavaman për 35-40 djem. 1 boks dhe lavaman për 30 vajza si dhe 1 boks dhe lavaman për administratën mundësisht dhe ujë të ngrohtë

Aktualisht ndjekin studimet në programet “Bachelor” 252 vajza dhe 154 djem, kurse në programet “Master” ndjekin studimet 137 vajza dhe 67 djem, pra gjithsej 389 vajza dhe 221 djem.

Ambientet e kolegjit universitar “Bedër” disponojnë 12 bokse sanitare dhe lavamanë për djem dhe 15 bokse sanitare dhe lavamanë për vajza.

Sa më lart:

për vajza: 1 boks për 28 vajza: $389 \text{ studente} \div 15 \text{ bokse} = 1 \text{ boks dhe lavaman për } 26 \text{ vajza};$

për djem: 1 boks për 27 djem: $221 \text{ studentë} \div 12 \text{ bokse} = 1 \text{ boks dhe lavaman për } 18 \text{ djem};$

ndërkohë që gjithsej gjendja paraqitet se disponohet 1 boks/27 studentë.

$610 \text{ (student) } / 27 \text{ (nyje hidrosanitare)} = 22.5$

Ambientet e institucionit disponojnë 13 bokse dhe lavamanë për personelin akademik dhe administrativ të KUB.

Sa më lart, vihet re që Kolegji Universitar “Bedër” i përmbush të gjitha specifikimet e kërkuara nga aktet nënligjore.

Lidhur me kërkesën e shtojcës (nr.3) të udhëzimit të sipërpërmendur që në ambientet e mësim, objekti duhet të plotësojë normativat teknike të ndricimit natyral, sipërfaqja e dritareve duhet

të mbulojë minimalisht (15 – 20) % të sipërfaqes së dyshemesë dhe ndriçimi duhet të jetë i orientuar nga krahu i majtë i studentit, mundësisht i orientuar nga juglindja. Ndriçimi duhet të realizohet nga dritare (rekomandohet me dopio xham) të tejdukshëm.

Numri i klasave, auditorëve, sipërfaqja e përgjithshme (m²) dhe kapaciteti

Gjatë vitit akademik 2018-2020, në Kolegjin Universitar “Bedër” janë përdorur nëntë klasa, tre auditorë dhe një laborator kompjuteri për zhvillimin e procesit mësimor. Klasat dhe auditorët janë të pajisur me projektor, dërrasë interaktive, kompjuter dhe ajër të kondicionuar.

Audiorët, klasat dhe laboratorët e kompjuterave kanë një kapacitet prej 486 studentësh, sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela 3

Klasa/ Auditore	Hapësira e brendshme (m2)	Kapaciteti (nr studentësh)	Orientimi	sipërfaqja e dritareve duhet të mbulojë minimalisht (15 – 20) % të sipërfaqes së dyshemesë
301 (auditor)	90	56	Jug dhe perëndim	
302	40	26	jug	
303	40	26	jug	
401 (auditor)	90	56	jug	
402 (lab. Kompjuteri)	40	24	jug	
403	40	26	jug	
501 (auditor)	90	56	Jug dhe perëndim	
502	40	26	jug	
503	40	26	jug	
701 (auditor)	70	60	jug	
702	40	24	ndricim i brendshëm	
MC 2	30	20	lindje	
MC 3	65	35	veri	
MC 4	40	25	Jug dhe perëndim	

Sa më lart, lidhur më këtë kriter, vihet re që institucioni i përmbush plotësisht kriteret për ndriçimin e klasave, auditorëve dhe laboratorëve të kompjuterave, ku zhvillohet mësim vazhdimisht, sepse një nga faqet e murit për çdo ambient është e pajisur me dritare të mëdha dopioxham, megjithëse nuk kemi të dhëna të sakta lidhur me sipërfaqet e dritareve në proporcion me sipërfaqen e dyshemesë.

Godina e KUB është e pajisur me shkallë emergjence, sipas kriterëve ligjore, por dyert e shkallëve të emergjencës për çdo kat janë prej xhami, duke rritur riskun e daljes në raste emergjente. Godina e dytë e përdorur nga Kolegji Universitar është e pajisur me dalje emergjente të ndara për katin e parë (kati 0) dhe shkallë e dalje emergjence për katin -1

Institucioni këtë kriter e plotëson në mënyrë të kënaqshme.

Kolegji Universitar “Bedër” ka të punësuar gjithsej 92 pedagogë, të ndarë këta në: 49 personel me kohë të plotë dhe 43 personel me kohë të pjesshme. Personeli është i ndarë në departamente sipas tabelës së mëposhtme:

Departamenti	Kohë e plotë	Kohë e pjesshme	Nr. student cikli 1	Nr. student cikli 2	Raporti 1:20
Gjuhë dhe Letërsi Angleze	7	2	74	84	17.5
Shkenca Edukimi	7	4	54	14	6.1
Shkenca Kompjuterike	8	10	48	-	2.6
Drejtësi	9	13	88	26	5.1
Shkenca Islame	7	7	33	29	4.4
Shkenca Komunikimi	11	7	109	51	8.8

Të gjitha departamentet përbërëse të Kolegjit Universitar “Bedër” plotësojnë kriteret e akteve nënligjore, çdo departament është i përbërë minimalisht nga 7 anëtarë efektivë, ndër të cilët, të paktën tre janë me gradë shkencore dhe/apo titull akademik.

Departamenti që ka raportin më të lartë është ai i Shkencave Kompjuterike me 1 pedagog për 2.6 studentë, ndërkohë departamenti me raportin më të ulët është ai i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, me 1 pedagog për 17.5 studentë.

Në Fakultetin e Shkencave Humane, numri i personelit akademik efektiv është 27, të shpërndarë në 3 departamente, ndër të cilët me gradë shkencore dhe/apo titull akademik janë:

1. Profesor: 1
2. Profesor i asociuar: 1
3. Doktor: 9
4. Master i shkencave: 16

Numri i personelit akademik joefektiv në Fakultetin e Shkencave Humane është 27, nga të cilët:

1. Profesor: 1
2. Profesor i asociuar: 2
3. Doktor: 9
4. Master i shkencave: 15

Në Fakultetin e Filologjisë dhe Edukimit numri i personelit akademik efektiv është 22, të shpërndarë në 3 departamente, ndër të cilët me gradë shkencore dhe/apo titull akademik janë:

1. Profesor: 0
2. Profesor i asociuar: 1

3. Doktor: 10

4. Master i shkencave: 11

Numri i personelit akademik joefektiv në Fakultetin e Filologjisë dhe Edukimit është 16, nga të cilët:

1. Profesor: 0

2. Profesor i asociuar: 0

3. Doktor: 5

4. Master i shkencave: 11

Për studimet e ciklit të parë dhe të dytë, raporti personeli akademik (i brendshëm + i jashtëm) është në nivele shumë të kënaqshme duke mundur punën intensive me studentët, për të mbështetur e monitoruar nga afër rritjen e tyre cilësore e profesionale vit pas viti.

Kolegji Universitar “Bedër” plotëson edhe kriteret që pedagogët e çdo lënde/moduli të ciklit të dytë, të kenë së paku gradën shkencore "Doktor".

INFRASTRUKTURA AKADEMIKE NË FUNKSION TË IAL SË/DEGËS/NJËSISË KRYESORE

Në Kolegjin Universitar “Bedër” janë në përdorim katërmbëdhjetë klasa dhe tre auditorë për zhvillimin e procesit mësimor. Klasat dhe auditorët janë të pajisur me projektor, dërrasë interaktive, kompjuter dhe ajër të kondicionuar. Sipërfaqet dhe kapacitetet në numër studenti të klasave dhe auditorëve, janë sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela 1

Klasa	Hapësira e brendshme (m ²)	Kapaciteti
302	45	24
303	40	24
403	40	24
502	45	24

503	40	24
601	40	18
602	45	24
603	40	24
702	46	36
MC2	50	20
MC3	45	40
MC4	48	30
MC5	80	55
MC6	42	35
301 (auditor)	96	68
401 (auditor)	96	68
501 (auditor)	96	68

Zyrat për personelin

kati-1	Sipërfaqja gjithsej	836 m2
kati 0	Biblioteka	230 m2
	Sekretaria mësimore	35 m2
	Zyra e pranimit	26 m2
	Zyra e PR	35 m2
kati 1	Doktori	16 m2
	Zyra e administratorit të Fakultetit	21 m2
	Zyra e Financës	14 m2
	Zyre personeli	21 m2
	Zyra e Plan. Karrierës	15 m2
	Zyra e IT	34 m2
kati 2	Zyra e Administratorit të Institucionit	21 m2
	Salla e Senatit	70 m2
	Zv. Rektori	45 m2
	Rektorati	26 m2
	Zyra e rektorit	42 m2
	Dhoma e pushimit	28 m2
	Zyra e burimeve njerëzore	21 m2
	Zyra e Kurrikulës/kërkimi Shk.	20 m2
	Zyre personeli	20 m2

	Dekani i Studenteve	23 m2
Kati 3	Përgjegjësi i departamentit	26 m2
	Zyre personeli	28 m2
	Administratori i Fakultetit	21 m2
	Dekani	32 m2
Kati 4	Sekretaria e Departamenteve	25 m2
	Zyrë personeli	28 m2
	Zyre personeli	20 m2
	Zyre personeli	35 m2
	Dekani	32 m2
Kati 5	Sekretaria e departamenteve	26 m2
	Zyre personeli	28 m2
	Zyre personeli	21 m2
	Zyre personeli	16 m2
	Përgjegjësi i departamentit	16 m2
Kati 6	Zyre personeli	15 m2
	Zyre personeli	20 m2
	Zyre personeli	20 m2
	Zyre personeli	28 m2
	Përgjegjësi i departamentit	21 m2
Kati 7	Zyre personeli	11 m2
	Zyre personeli	10 m2

	Zyrë personeli	22 m ²
--	----------------	-------------------

Në Kolegjin Universitar “Bedër” janë në përdorim dy salla kompjuterash (402/701) me sipërfaqe 40 m² dhe 70 m² dhe me kapacitet 24 dhe 40 studentë. Salla e konferencave (H1) ka një sipërfaqe prej 200 m² dhe një kapacitet prej 180 vendesh.

Në shërbim të studentëve është edhe salla e gjyqit imitues, e departamentit të Drejtësisë, e cila mund përdoret edhe nga studentët e departamenteve të tjera të kolegjit universitar.

Neës Room është një prej risive të kolegjit Universitar “Bedër”, një ambient i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, por që mund të përdoret edhe nga departamentet e tjera. Neës Room përbëhet nga 10 kompjutera dhe tavolina leximi dhe mund të përdoret në të njëjtë kohë edhe si laborator i dytë kompjuteri.

Biblioteka e Kolegjit Universitar “Bedër” vjen në shërbim të studentëve dhe personelit me një sipërfaqe 200 m², me kapacitet 65 poste leximi. Në bibliotekë gjenden 32600 tituj shkencorë, 36000 libra, 166 monografi shkencore dhe 48 revista shkencore.

Biblioteka është e abonuar në revista shkencore online si Elsevier, Ebasco. Gjithashtu biblioteka ka të drejtë përdorimi të EBSCO-host, ku mund të gjenden baza të dhënash kërkimore që mbulojnë një larmi temash. Së fundmi biblioteka është abonuar në librarinë digjitale JSTOR, që u mundëson studentëve dhe personelit hyrje në këtë bibliotekë madhështore botërore. JSTOR mundëson përdorimin e më shumë se 12 milion artikujve të revistave shkencore në disa gjuhë.

Duke patur parasysh që bazuar në sipërfaqet që ofron, institucioni ka kapacitete maksimale pritjeje për 1066 studentë, por kapacitete minimale pritjeje për 790 studentë si dhe numrin për ciklin e parë dhe të dytë për çdo departament të Kolegjit Universitar “Bedër”, si dhe prirjen e studentëve të regjistruar vit pas viti në departamente, propozojmë që kuotat për vitin akademik 2020-2021, të jenë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Programi i studimit	Kuotat e studimit
1	Bachelor në Arsim Parashkollor dhe Fillor	0
2	Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze	35
3	Bachelor në Shkenca Kompjuterike	35
4	Program profesional dyvjeçar në Programim në Web	35
5	Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi	30
6	Bachelor në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji	0
7	Bachelor në Shkenca Komunikimi	30

8	Bachelor në Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu	35
9	Bachelor në Shkenca Islame	15
10	Bachelor në Drejtësi	40
11	Program profesional dyvjeçar në Multimedia dhe Dizajn Grafik	33
Totali		288


Nr.	Programi i studimit	Kuotat e studimit
1	Master i Shkencave në Gjuhë dhe Letërsi Angleze	25
2	Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji	0
3	Master i Shkencave në Drejtësi / Profili e Drejta Ndërkombëtare	12
4	Master i Shkencave në Drejtësi / Profili e Drejta Penale	23
5	Master i Shkencave në Shkenca Moderne Islame	10
6	Master i Shkencave në Shkenca Themelore Islame	15
7	Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi / Profili Gazetari	10
8	Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi / Profili Marrëdhënie me Publikun	22
9	Master Profesional në Mësuesi, Gjuhë Angleze për Arsimin e Mesëm	40
10	Master Profesional në Komunikim Marketingu	20
Totali		177

9. ANKETAT


9.1 ANKETA NË LIDHJE ME MËSIMDHËNIEN NË DISTANCË

Në këtë anketë kanë marrë pjesë 281 studentë bachelor dhe master, 78% e të cilëve janë studentë të ciklit të parë dhe 22% të ciklit të dytë. Pjesëmarrjen më të lartë e kanë studentët e departamentit të shkencave të komunikimit dhe të departamentit të gjuhës dhe letërsisë angleze, kjo për shkak dhe të numrit më të lartë të studentëve të regjistruar në këto programe. Gjithashtu vlen për të theksuar se pjesëmarrja e studentëve të vitit të parë dhe të dytë është me një përqindje të barabartë, nga 41% dhe e studentëve të vitit të tretë 18%.


1. Gjinia/ Gender




2. Cikli i studimit/ Cycle of study



3. Departamenti/ Department



4. Viti/ Year of study




Bazuar në seksionin e dytë të anketimit, vërejmë se mbi 91% e studentëve janë regjistruar në të gjitha platformat për ndjekjen e mësimdhënies online, 7% në disa prej lëndëve dhe vetëm 2% e tyre në asnjërën prej lëndëve semestrale. Këtu vërejmë që pjesëmarrja e studentëve dhe ndjekja e leksioneve ka qenë në përqindje të lartë.


Aplikacioni më i përdorur nga studentët për këtë semestër është Smartphone, më pas vjen laptopi, kompjuteri dhe tableta. Përgjithësisht janë përdorur video-takimet dhe leksionet me e-mail për zhvillimin e mësimdhënies online.

Përsa i përket pjesës së vështirësive të hasura, ato janë të lidhura më shumë me shpejtësinë e ulët të internetit ose me mungesën e tij përsa i përket anës teknike, ndërsa përsa i përket anës ekonomike, psikologjike apo shëndetësore, vërejmë që shumica e studentëve kanë hasur më shumë vështirësi psikologjike gjatë kësaj periudhe.


5. Jeni regjistruar në platformat për ndjekjen e leksioneve online?/ Are you registered on the platforms for attending online lectures?




6. Cilën pajisje keni përdorur për të ndjekur mësimet online? (zgjidhni të gjitha alternativat e vlefshme për ju)/ Which of these applications did you use for online studing? (Choose all applicable options)




7. Cilën nga metodat e mëposhtme keni përdorur për zhvillimin e mësimet online? (zgjidhni të gjitha alternativat e vlefshme për ju)/ Which of the following methods have you used for your online learning? (Choose all applicable options)



8. A keni hasur vështirësi gjatë mësimit online? Did you face any challenges during online learning?




9. Cilat nga vështirësitë e mëposhtme keni hasur gjatë mësimit online (zgjidhni të gjitha alternativat e vlefshme për ju)/ Which of the following difficulties have you encountered during this period (Choose all applicable options)




Shkalla e vështirësisë nga 1 (vështirësi e ulët) deri në 3 (vështirësi e lartë)


10. Ngarkesë psikologjike/ Psychological burden:



11. Vështirësi ekonomike/ Financial difficulties:



12. Probleme shëndetësore/ Health issues:




Bazuar në seksionin e tretë të anketimit, platformat e përdorura nga stafi për mësimdhënien online kanë rezultuar pozitive dhe të suksesshme, duke përshtatur metodologjinë e mësimdhënies me mundësinë për përvetësimin e saj. Vërehet se pedagogët dhe studentët janë përshtatur përgjithësisht me detyrat/ projektet por vërehet që pjesa e ngarkesës me leksione, seminare dhe detyra duhet të përshtatet më tepër me mësimdhënien në distancë.


Angazhimi i pedagogëve, departamenteve dhe institucionit kanë qenë në nivele të kënaqshme.

- 1- Aspak dakord
- 2- Nuk jam dakord
- 3- Asnjëanës
- 4- Dakord
- 5- Plotësisht dakord


13. Platformat (Google Meet, Zoom, etj.) që kemi përdorur për mësimin online janë të përshtatshme/ The platforms (Googlemeeet, Zoom, etc) used for online learning are effective.




14. Metodologjia e mësimdhënies është përshtatur për të mundësuar përvetësimin gjatë mëimit online/ Teaching methodology has been adapted to facilitate learning during online learning




15. Detyrat/projektet janë të qarta dhe të realizueshme për situatën/ Tasks/projects are clear and feasible for the situation




16. Ngarkesa me leksione, seminare dhe detyra është e përballueshme/ Work load (lectures, seminars and assignments) is manageable




17. Organizimi i provimeve është përshtatur me kushtet e mësimdhënies online/ The organization of exams has been adapted to suit online learning




18. Mënyra/kriteret e vlerësimit janë përshtatur me mësimdhënien online/ The assessment method/criteria have been adapted to online learning




19. Angazhimi i departamentit dhe pedagogëve gjatë kësaj periudhe ka qenë në nivelin e duhur/ The commitment of the department and lecturers during this period has been satisfactory




20. Angazhimi i institucionit gjatë kësaj periudhe ka qenë në nivelin e duhur/ The commitment of the institution during this period has been satisfactory




21. Mendoj se i kam arritur objektivat e studimeve gjatë periudhës së pandemisë/ I think I have achieved the objectives of my studies during the pandemic period



22. Përvoja me mësimdhënien online në përgjithësi ka qenë pozitive/ My overall experience with online learning has been positive



23. E kam të domosdoshme (të nevojshme) përsëritjen gjatë periudhës që do të hapen auditorët/ I need to repeat/retake course during the summer period



24. Ju lutemi specifikoni numrin e lëndëve për të cilat do të jetë e nevojshme përsëritja/ Please specify the number of the courses that you need to repeat

Pyetjes në lidhje me numrin e lëndëve për të cilat është e nevojshme përsëritja i janë përgjigjur 86 studentë.

25. Cilat janë sugjerimet tuaja për mbylljen e semestrit në mënyrë sa më efektive? (nëse keni)/ Do you have any suggestions for improvement to your learning experience or to a successful completion of this term?

Pyetjes së sugjerimeve i janë përgjigjur 146 studentë.

Analizë e anketës dhe sugjerime nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në lidhje me anketën “Mësimdhënia në distancë”:

1. Mbyllja e vitit akademik 2019-2020 dhe zhvillimi i provimeve online.
2. Ngarkesa mësimore e studentëve të jetë e shpërndarë në kohëzgjatje kohore përsa i përket detyrave, projekteve dhe provimeve.
3. Shtyrja e afatit të dorëzimit të tezave për programet master dhe të provimeve finale për të dy ciklet.
4. Rikuperimi i temave të pazhvilluara ose atyre me të cilat është hasur vështirësi për një periudhë 1 mujore në auditor për studentët që paraqesin kërkesa, duke marrë të gjitha masat higjeno-sanitare kundër pandemisë COVID- 19.

Shumica e studentëve kanë shprehur kënaqësinë në lidhje me mënyrën e zhvillimit dhe të koordinimit të mësimdhënies në distancë nga ana e pedagogëve dhe